



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 36/2023 regjistër (JR)  
Datë 26.07.2023

Nr. 47 i vendimit  
Datë 16.06.2025

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 16.06.2025, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, vendimin përfundimtar të marrë më datë 09.06.2025, mbi çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, z. Hyrjet Lamaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, dëgjoji në seancë publike subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij, z. Theodhori Sollaku, të cilët përfundimisht kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatore të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hyrjet Lamaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”), dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Hyrjet Lamaj<sup>1</sup>, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj, në raportin e përditësuar, të përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2022, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Hyrjet V. Lamaj*.<sup>2</sup>

2.3 KLP-ja ka dërguar në Komision raportin vlerësues për subjektin e rivlerësimit Hyrjet

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Hyrjet Lamaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

<sup>2</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.11.2022, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Lamaj.<sup>3</sup> Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet si më poshtë:

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] *Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, u evidentuan problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë, nga ku rezultoi se ai ka kryer deklarin të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, dhe se nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij.*

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] *Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, duke vlerësuar indiciet për t'i marrë në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të subjektit të rivlerësimit.*

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] *subjekti i rivlerësimit e ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.*

4. Në përfundim, bazuar në nenin 4, pika 2, shkronja “c”, nenin 58, pika 1, si dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, me vendimin nr. 668, datë 26.05.2023, Komisioni vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

## **III. Shkaqet e ankimit**

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 668, datë 26.05.2023, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit Hyrjet Lamaj, nëpërmjet të cilit kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë.
6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat, në tërësinë e tyre, kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësim të provave të administruara nga Komisioni, ashtu siç ai pretendon.
7. Shkaqet procedurale të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, lidhen kryesisht në pretendimin për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), si dhe marrjen e vendimit për fakte, shkaqe apo rrethana, për të cilat subjekti nuk i ka kaluar paraprakisht barra e provës.

---

<sup>3</sup> *Raportin me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.06.2022, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit”.*

8. Shkaqet e ankimit, që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijojnë:

8.1. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë është i pambështetur në provat e administruara, si dhe në parashikimet ligjore, të cilat normojnë këtë proces.

8.2. Në lidhje me pasurinë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka arritur në konkluzionin e gabuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr.84/2016, mbi bazën e disa indicieve, të cilat nuk mundet kurrsesi të mbështesin konkluzionin se kjo pasuri është një pasuri e krijuar që nga fillimi nga subjekti i rivlerësimit.

8.3. Në lidhje me pasuritë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*} dhe “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit mbi çmimin e kontraktuar të shitjes / blerjes së këtyre pasurive është tërësisht i pabazuar dhe tregon paragjykim dhe paracaktim të vendimmarrjes, si dhe vjen në kundërshtim me vendimmarrjet e mëparshme të Komisionit dhe jurisprudencën e Kolegjit.

9. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të merren në cilësinë e provës, aktet shkresore si vijon:

9.1 8 (tetë) deklaratat noteriale të familjarëve të subjektit, të përfshirë në marrëdhënien e pronësisë së pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë,<sup>4</sup> si dhe administratorëve të shoqërisë ndërtuese, të cilët kanë bërë deklaratime mbi rrethanat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, sa i përket prenotimit fillestar të kësaj pasurie, rrethanat e blerjes së saj nga vëllai i subjektit, arsyet e dhurimit të kësaj pasurie subjektit, si dhe mbi burimet e pretenduara të të ardhurave, që i kanë shërbyer vëllait të subjektit M. L. për ta krijuar atë. Bashkëlidhur tyre, ndër të tjera, gjenden:

9.2 Dokumentacion mbi gjendjen shëndetësore dhe trajtimin mjekësor të nënës së subjektit të rivlerësimit në Itali<sup>5</sup>.

---

<sup>4</sup> Deklaratë noteriale e vëllait të subjektit, z. M. L., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 10.07.2023. Bashkëlidhur, kërkesë për informacion, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, lidhur me pasuritë në emër të M. dhe E. L., si dhe shkresa “kthim përgjigje” e kësaj agjencie; (ii) Deklaratë noteriale e shtetasit M. L., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 11.07.2023; deklaratë noteriale e shtetasit E. L., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 10.07.2023, së bashku me kopje diplome, nr. {\*\*\*}, datë lëshimi 16.07.2005, në emër të E. P. C. dhe dokumente të kontrolleve mjekësore të nënës së subjektit; deklaratë noteriale e shtetasit V. L., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 12.07.2023; deklaratë noteriale e shtetasit E. L., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 12.07.2023, së bashku me dokumente shkollorë të shtetasve L. L., K. L. dhe I. L.; deklaratë noteriale e shtetasit N. M., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 13.07.2023, së bashku me kopje mandati banke, lëshuar nga Alpha Bank; deklaratë noteriale e shtetasit K. Xh. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me administrator shtetasin H. Xh., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 13.07.2023; deklaratë noteriale e shtetasit M. L., me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 10.07.2023; deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 10.07.2023, në të cilën vëllai i subjektit, z. M. L., ka deklaruar se ka arritur të sigurojë dokumentacion shtesë për të provuar mundësinë e tij financiare për krijimin e pasurisë me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, pasi për shkak të kohës së kufizuar dhe angazhimeve profesionale, nuk ka mundur të sigurojë përpara seancës gjyqësore, dhe vetëm në datën 08.06.2023, ka arritur t’i tërheqë në formën e kërkuar nga ligji. Subjekti ka paraqitur aktin “Deklaratë zëvendësuese e aktit noterialë datë 08.06.2023”.

<sup>5</sup> Njësia Sanitare, Rajoni Piemonte - Struktura Komplekse e {\*\*\*}.

9.3 Akt ekspertimi grafik nënshkrimesh, nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2023.<sup>6</sup>

9.4 Komunikime elektronike të vëllait të subjektit, drejtuar filialeve të bankave në të cilat ka pasur llogari bankare në Itali.

9.5 Deklaratë zëvendësuese e aktit noterial, datë 08.06.2023, lëshuar nga z. S. G., ish-administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” {\*\*\*}, ekstrakt historik pa vlerë certifikimi, lëshuar nga Dhoma e Tregtisë, Industrisë Artizanale e Bujqësisë Milano, Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve, i cili deklaroi se gjatë kohës që ai ka qenë administrator, vëllai i subjektit, M. L., ka qenë punonjës social pranë kësaj shoqërie, për një periudhë 4-vjeçare (2005 – 2009), si dhe ka kryer detyrat e infermierit, për të cilën ka përfutur pagesën fikse, neto mujore prej 1.800 eurosh, në total në vlerën 86.400 euro.

10. Më datë 28.02.2025, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj kërkesën për të administruar në cilësinë e provës, komunikimet elektronike të vëllait M. L. me institucionet bankare në Itali. Po ashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me gjendjen shëndetësore dhe diagnozat e nënës së tij nga vizitat mjekësore në shtetin Italian, që i përkasin vitit 2012.<sup>7</sup>

Subjekti i rivlerësimit, më datë 19.05.2025, paraqiti në Kolegj parashtrime me shkrim mbi shkaqet e ngritura në ankim, sikurse parashikon neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, duke kërkuar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja, çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të dorëzuara me ankimin, dhe atyre shtesë të dërguara më datë 28.02.2025.

#### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

###### (a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (në vijim “Kushtetuta”) dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (në vijim “Aneksi i Kushtetutës”), si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim – për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë – bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>6</sup> Shtesë e aktit të ekspertimit grafik, nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2023, të ekspertit kriminalist Xh. Ç..

<sup>7</sup> Komunikimet janë me: (i) Bankën Popullore të Milanos; (ii) Bankën e Piemontes, nëpërmjet të cilave ka kërkuar ekstrakte të llogarive bankare pranë këtyre institucioneve, për periudhën janar 2005 - tetor 2011. Komunikimet elektronike, si dhe dokumentet mbi gjendjen shëndetësore të nënës së subjektit dhe vizitat mjekësore, janë paraqitur të përkthyer, të noterizuara dhe me vulë apostile.

(b) Legjitimimi i ankuesit

12. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

(c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

13. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj, u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues, në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 26.05.2025, mbi bazë aktesh.
14. Trupi gjykues, për të vendosur mbi formën e shqyrtimit të çështjes, shqyrtoi fillimisht shkaqet ankimore me natyrë procedurale, për të evidentuar nëse ka shkelje, të tilla që do të cenonin procesin e rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, e që do ta legjitimonin atë për një shqyrtim gjyqësor në seancë gjyqësore publike, konkretisht:

14.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se ndaj tij është zhvilluar një proces në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, pasi gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme dhe anëtarët e Komisionit nuk përmbushin kushtet e zgjedhshmërisë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se qëndrimi i mbajtur deri në këtë moment nga Kolegji është në kundërshtim me Aneksin e Kushtetutës, vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDN”) në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë” dhe, për këtë arsye, duhet të ndryshojë praktikën e tij dhe të marrë në shqyrtim pretendimet e subjektit në lidhje me mospërmbushjen e kritereve ligjore nga anëtarët e rivlerësimit dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre, pasi shkarkimi i tij është pasojë e drejtpërdrejtë edhe e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit.

14.1.1 Në analizë të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues sjell në vëmendje se në çështjen gjyqësore “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, për pretendime të njëjta, GjEDNj-ja ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, në drejtim të parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme dhe përmbushjes së kushteve të zgjedhshmërisë të anëtarëve të Komisionit<sup>8</sup>. Kolegji i ka trajtuar këto pretendime gjerësisht në jurisprudencën e tij të konsoliduar dhe i ka vlerësuar ato të pabazuara<sup>9</sup>. Në rastin objekt shqyrtimi, kërkesa e subjektit nuk mbështetet në rrethana të ndryshme nga ato të trajtuara më parë nga Kolegji në jurisprudencën e tij.

14.2 Subjekti pretendon se Komisioni ka vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje

<sup>8</sup> Paragrafi 230 e vijues i vendimit të GjEDNj-së, “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”.

<sup>9</sup> Shih vendimet e Kolegjit, ndër tjerë, (JR) nr. 8/2021, nr. 19/2022; nr. 23/2022; nr. 32/2023; nr. 1/2023 dhe nr. 54/2023 etj.

të parimit të prezumimit të pafajësisë, çka ka ndikuar në humbjen e ekuilibrit përgjatë vlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Në të gjithë procedurën e ndjekur dhe vendimin objekt ankimi, subjekti pretendon se ka elemente të theksuara të një vendimi të paracaktuar dhe, për këtë arsye, subjekti nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së apo nenit 42 të Kushtetutës.

**14.2.1** Nga shqyrtimi i akteve të administruara, trupi gjykues nuk eidenton të dhëna se vendimi ka qenë i paracaktuar apo i paragjykuar. Përpos kësaj, vetë subjekti nuk shpjegon dhe nuk shtjellon se çfarë e motivon, sipas tij, këtë lloj sjelljeje të Komisionit. Nga ana tjetër, procesi i rivlerësimit është tërësisht administrativ dhe kryhet mbi parimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe, kur është rasti, mund të zbatohen edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative. Ndërkohë, shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë është një parim i procesit penal, çka nuk gjen zbatim dhe mbështetje në këtë proces.

Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet kur asnjë e dhënë në aktet e administruara dhe as në parashtrimet e subjektit nuk tregon qoftë edhe indicie të anshmërisë, pretendimet e tij për tendenciozitet, paragjykim apo paracaktim të vendimit, vlerësohen nga trupi gjykues të pambështetura në fakte dhe si një përpjekje me synim cenimin e procesit të kryer në kontekstin e themelit, duke ngritur shkaqe ankimi mbi rrethana që, jo vetëm nuk konstatohen se ekzistojnë, por anashkalojnë konkluzionet e Komisionit për to.

**14.3** Subjekti i rivlerësimit pretendon për shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së, të së drejtës për siguri juridike, për mosrespektimin e jurisprudencës së Komisionit dhe Kolegjit për çështje me rëndësi vendimtare për subjektin dhe shkelje të parimit të ligjshmërisë, për shkak të ekzistencës së gjykimeve të kundërta, sa i përket largimit të pajustificuar të Komisionit nga vendimmarrjet e mëparshme, por dhe nga jurisprudenca e Kolegjit: (i) lidhur me kufijtë e kryerjes së analizës financiare<sup>10</sup> për personat e lidhur; (ii) vlerësimit mbi fiktivitetin e çmimit të automjetit, duke u bazuar në çmimin më të madh apo të vogël të shitjes së automjeteve, si dhe (iii) arritja e konkluzioneve pa i kaluar barrë prove. Subjekti pretendon se, në kundërshtim me pritshmërinë e tij, Komisioni nuk zbatoi parimet legjitime që ka marrë parasysh në raste të tjera. Çdo shmangie nga jurisprudenca duhet të shoqërohet me një deklaratë thelbësore të arsyeve që kërkojnë largimin prej qëndrimeve të mëparshme të gjykatës<sup>11</sup>. Komisioni nuk ka paraqitur asnjë arsyetim se përse nuk e ka zbatuar në çështjen e subjektit këtë parim, i cili ishte i një rëndësie vendimtare, pasi këto çështje kanë peshë specifike kryesore në vendimmarrjen përfundimtare.

**14.3.1** Trupi gjykues, në analizë të këtij shkakut ankimor, lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të ekzistencës të gjykimeve të kundërta, thekson se vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, çka adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës.<sup>12</sup> Në këto kushte, pretendimet e mësipërme, të ngritura nga subjekti i

---

<sup>10</sup> Subjekti i referohet vendimit të Kolegjit nr. 2/2023 (JR).

<sup>11</sup> "Atanasovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", "Domenech Aradilla dhe Rodrigues Gonzalez kundër Spanjës".

<sup>12</sup> Shih "Beian kundër Rumanisë (nr. 1), §§ 37 dhe 39; Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë [DHM], §§ 116-35).

rivlerësimit, do të analizohen në koherencë me jurisprudencën e Kolegjit, vlerësuar nën dritën e rrethanave konkrete dhe provave të administruara për çështjen, në përgjigje të shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në vijim, në këtë vendim.

14.4 Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është *marrë për fakte, shkaqe apo rrethana, për të cilat subjektit nuk i ka kaluar paraprakisht barra e provës* për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Përbushja e këtij detyrimi ligjor nga ana e organeve të rivlerësimit, lidhet me të drejtën që ka subjekti që të dëgjohet dhe të mbrohet në mënyrë efektive, përpara se ndaj tij të merret masa disiplinore. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, për shkak të mosrespektimit të procesit të rregullt ligjor. Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t'u dëgjuar drejtësisht dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive. Ky parim mbështetet edhe nga parashikimet e nenit 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili referon në nenin 87, pikat 1 dhe 2, shkronja "ç" të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë". Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, lidhur me automjetet, se: *"subjekti rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë, duke deklaruar çmim joreal për blerjen dhe shitjen më pas"*, jo vetëm që nuk i është njoftuar si gjetje, por në fakt, në rezultatet e hetimit është konkluduar e kundërta, që *subjekti ka burime të ligjshme financiare për blerjen e këtyre pasurive*, ndërkohë në vendimin përfundimtar, Komisioni e mbështet masën disiplinore në këto fakte:

14.4.1 Trupi gjykues, në përgjigje të këtij shkakut ankimor, analizoi aktin "Rezultatet e hetimit", nga i cili konstaton se Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë *shpjegime dhe dokumentacion provues*, pasi ka konstatuar se: (1) Automjeti "Mercedes-Benz", me targa {\*\*\*}, blerë nga subjekti i rivlerësimit më datë 16.02.2012, në vlerën 400.000 lekë, është shitur nga ky i fundit më datë 10.04.2013, në vlerën 500.000 lekë, më shtrenjtë sesa është blerë; si dhe, (2) Automjeti "Mercedes-Benz", me targa {\*\*\*}, është blerë nga subjekti më datë 27.05.2013, në vlerën prej 600.000 lekë, më lirë se çmimi fillestar i blerjes së kësaj pasurie nga pala shitëse më datë 13.03.2013, në vlerën prej 859.618 lekë. Këto gjetje duket se janë trajtuar fillimisht nga Komisioni në rezultatet e hetimit, në drejtim të besueshmërisë së çmimit të deklaruar në kontratat e shitblerjes dhe jo të pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e tyre nga ana e subjektit, për sa kohë nga analiza financiare, Komisioni ka konstatuar se subjekti, si në vitin 2012, ashtu dhe në vitin 2013, ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtyre automjeteve.

Këto gjetje duket se janë trajtuar nga Komisioni, në drejtim të besueshmërisë së çmimit të deklaruar në kontratat e shitblerjes dhe jo të pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e tyre. Lidhur me këtë fakt, ndërsa duket që pretendimi i subjektit të rivlerësimit qëndron, lidhur me mungesën e kalimit të barrës së provës mbi pamundësinë financiare për blerjen e automjeteve, trupi gjykues vlerëson se peshën që kjo rrethanë ka në vendimmarrjen e Komisionit do e vlerësojë në vijim në këtë vendim, në raport me shkaqet e ankimit me natyrë materiale, që lidhen me analizimin e problematikave të vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.

14.5 Në përmbledhje të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të rënda procedurale dhe për shkelje të parimeve të procesit të rregullt

ligjor gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, u gjetën të pabazuara në fakte e në ligj.

14.6 Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të shkaqeve të ankimit, ka kërkuar që Kolegji të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike me praninë e tij, duke riçelur / përsëritur hetimin gjyqësor, me qëllim marrjen në shqyrtim edhe të provave të paraqitura bashkëlidhur ankimit, si dhe analizimin e provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të gjendjes faktike. Në rastin konkret, sipas subjektit, plotësohen kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në të cilin parashikohet: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.* Këto akte janë depozituar në funksion të ligjshmërisë së të ardhurave të z. M. L. (vëllai i subjektit) dhe të rrethanave që nxitën blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”. Subjekti pretendon se nuk ka qenë e mundur që këto prova të merren në kohë, për shkak se vëllai i tij jetonte jashtë vendit, si dhe për shkak të kohës së pamjaftueshme pas kalimit të barrës së provës. Bazuar në pritshmërinë e tij të ligjshme, në vlerësimin e subjektit, këto prova janë të nevojshme.

14.7 Trupi gjykues, kërkesën e subjektit për marrjen në cilësinë e provës, të akteve të paraqitura, e analizoi në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë dhe në procesin e rivlerësimit, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, dhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në konsideratë të efektit që ato sjellin në shqyrtimin e shkaqeve materiale në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

14.7.1 Lidhur me *deklaratat noteriale* të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues mban në vëmendje qëndrimin e konsoliduar që ka mbajtur Kolegji në jurisprudencën e tij në çështje të ngjashme, sipas së cilave, deklaratat noteriale, megjithëse nuk janë të pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e tyre provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga rrethanat apo provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues, referuar jurisprudencës<sup>13</sup> së tij, arsyeton se deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, për më tepër, në kushtet kur ato nuk mbështeten dhe nuk vijnë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

14.7.2 *Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti mbi gjendjen shëndetësore* dhe trajtimin e nënës së subjektit të rivlerësimit nga Shërbimi Kombëtar i Rajonit Piemonte, Struktura Komplekse e {\*\*\*}, ndër të tjera, mban të dhëna mbi vendosjen e impiantit *Pacemaker*, si dhe diagnoza mjekësore të znj. N. L., që i përkasin vitit 2012, periudhë në të cilën mjekët i kanë rekomanduar kontrollë të vazhdueshme, rrethana të cilat, sipas pretendimeve të subjektit, kushtëzuan blerjen për prindërit, të apartamentit ngjitur me subjektin, me qëllim që ato të jetonin në qytet dhe subjekti të kishte mundësi të kujdesej për to. Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në Kolegji, përveç se është sjellë në formën e kërkuar nga ligji, nuk paraqet

---

<sup>13</sup> *Vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2 etj.*

ndonjë rrethanë të re me ndikim në vendimmarrje, pasi ai është paraqitur nga subjekti dhe është administruar gjatë hetimit në Komision.

14.7.3 Sa i përket *Aktekspertimit grafik nënshkrimesh, nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2023*, shtesë e aktit të ekspertimit grafik nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2023, trupi gjykues vëren se, në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për konstatimin se vëllai i subjektit të rivlerësimit, M. L., nuk ka qenë në Shqipëri më datë 19.06.2012, ditën e nënshkrimit të kontratës së blerjes së pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, e cila, më pas, i është dhuruar subjektit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar nënshkrimin e kontratës në një kohë të ndryshme nga ajo e shënuar në këtë akt noterial, duke paraqitur si dokumentacion provues “Aktin e ekspertimit grafik të nënshkrimeve”, me nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2023.<sup>14</sup> Nga fashikulli gjyqësor i Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, me *email*-in e datës 26.05.2023, ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore për shpalljen e vendimit, ka përcjellë në Komision edhe aktin nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2023. Në konsideratë të rezultateve të dy aktekspertimeve, trupi gjykues vlerëson se akti i ri i ekspertimit i paraqitur nga subjekti, përveç se nuk sjell ndonjë rrethanë të re, e cila do të ndikonte në vendimmarrje, gjendet i administruar në fashikullin e Komisionit.

14.7.4 Nga *komunikimet elektronike* të vëllait të subjektit, drejtuar filialeve të Bankës Popullore të Milanos dhe Bankës së Piemontes, për të siguruar ekstrakte të llogarive bankare që i përkasin periudhës 2004 – 2011, nuk rezulton që të jenë administruar të dhëna të reja apo të pasqyrohet një situatë e ndryshme faktike / juridike mbi të ardhurat e tij, nga ajo që ka ekzistuar në momentin e dhënies së vendimit nga Komisioni. Për rrjedhojë, këto akte nuk paraqesin ndonjë rrethanë apo fakt të ri, me ndikim në vendimmarrje.

14.7.5 Në mbështetje të parashikimeve ligjore, që normojnë trajtimin e provës në këtë proces, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për administrimin në cilësinë e provave të reja në Kolegj, përpos sa më sipër arsyetuar, në vlerësim të trupit gjykues, nuk mund të analizohet në këndvështrim të nenit 47, të ligjit nr. 49/2012, me arsyetimin se: (i) lidhur me deklaratat noteriale, subjekti nuk ka provuar mospasjen mundësi, jo për faj të tij, për t’i paraqitur ato që në fazën e hetimit administrativ në Komision; (ii) akti i ekspertimit grafik nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2023, si dhe dokumentacioni mbi gjendjen shëndetësore të nënës së subjektit, gjendet i administruar në fashikullin e Komisionit, dhe nuk përbëjnë provë të re; (iii) komunikimet elektronike të vëllait të subjektit të rivlerësimit me institucionet bankare në Itali, edhe sikur të ishin në plotësim të kërkesave të kësaj dispozite ligjore, përsëri ato konsiderohen të panevojshme dhe pa ndikim në zgjidhjen e çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

14.8 Lidhur me aktin *Deklaratë zëvendësuese, akt noterial, datë 08.06.2023*, lëshuar nga z. S. G., paraqitur bashkëlidhur deklaratës noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.07.2023, në të cilën vëllai i subjektit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *ka arritur të sigurojë dokumentacion provues për të ardhurat shtesë të ligjshme, si punonjës social i Kooperativës [...], ku ka qenë i punësuar për periudhën 4-vjeçare, 2005 – 2009, me pagë mujore fikse 1.800*

---

<sup>14</sup> Referuar aktit, rezulton se nënshkrimet në emër të M. L., që gjenden në dy ekzemplarët e dokumentit “Kontratë banimi me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 19.06.2012”, janë nënshkruar nga i njëjti person, M. L., krahasuar me modelet e paraqitura. Si modele të shkrimit të tij, ekspertit i janë vënë në dispozicion, kontrata e datës 11.06.2012, kontrata e dhurimit e vitit 2015, si dhe dokumenti pasaportë, me datë lëshimi 01.11.2010.

euro, që në total arrin 86.400 euro, dokument ky i pajisur me vulë apostile nga Prefektura Vercelli, më datë 08.06.2023, ndonëse edhe ky dokument nuk plotëson kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në këtë moment procedural, trupi gjykues vlerëson se ky akt do të merret në konsideratë me rezervë dhe vlera e tij provuese do të trajtohet në vijim, në harmoni me aktet e tjera të administruara në fashikullin gjyqësor të Komisionit dhe në zbatim të legjislacionit të zbatueshëm.

14.9 Trupi gjykues, në përfundim të bisedimeve, në shqyrtim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e tij, në kushtet kur rrethanat e rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me pasurinë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, me vendndodhje në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, kanë pasur efekt domethënës në vlerësimin e kontrollit të kriterit të pasurisë, si dhe duke qenë arsyeja kryesore për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, vendosi vijimin e gjykimit të kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, për të konstatuar në mënyrë të plotë situatën faktike, lidhur me mënyrën e krijimit të kësaj pasurie.

14.10 Në seancën gjyqësore publike të datës 09.06.2025, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor<sup>15</sup>, u dëgjua nga trupi gjykues teksa paraqiti sqarimet e tij lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, të ndodhur në qytetin e Vlorës. Përfaqësuesi ligjor i subjektit deklaroi se vendimi i Komisionit është i pabazuar në fakte dhe në ligj dhe i kërkoi Kolegjit që, pasi të marrë në konsideratë sqarimet e plota mbi ligjshmërinë e pasurisë objekt shqyrtimi, të disponojë me një vendim të drejtë, të paanshëm, të bazuar në prova. Subjekti i rivlerësimit, në këtë seancë iu përgjigj disa pyetjeve të ngritura nga gjyqtarja relatore e çështjes, në funksion të këtij shqyrtimi gjyqësor dhe, në përfundim, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit, dhe konfirmimin e tij në detyrë. Trupi gjykues vendosi mbylljen e shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe u tërhoq në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit përfundimtar, të cilin deklaroi se do ta shpallte më datë 11.06.2025, ora 10:00.

14.11 Seanca gjyqësore e planifikuar më datë 11.06.2025, për shpalljen e vendimit përfundimtar, nuk u zhvillua, në pamundësi objektive të formimit të trupit gjykues. Në këtë seancë u bë me dije që vendimi është marrë më datë 09.06.2025, si dhe u vendos shtyrja e shpalljes së tij më datë 16.06.2025. Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, e pranishme në këtë seancë gjyqësore, mori njoftim, duke u konsideruar kështu i njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit.

## **B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e zbatimit të ligjit material dhe konstatimit të drejtë të situatës faktike**

15. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë është i pambështetur në provat e administruara, si dhe parashikimet ligjore që normojnë këtë proces. Komisioni ka nxjerrë konkluzione të gabuara, duke konkluduar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm. Subjekti pretendon se nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram

---

<sup>15</sup> Avokat Theodhori Sollaku. Në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në këtë gjykim do përfaqësohet nga dy mbrojtës, në prani dhe në mungesë të tij, av. Theodhori Sollaku dhe av. Romina Zano.

të rremë dhe deklarimet e tij janë në përputhje me ligjin. Në vlerësimin dhe interpretimin sistematik dhe logjik që i bëhet Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se asnjë sanksion nuk mund të zbatohet ndaj subjekteve të rivlerësimit, nëse organet verifikuese nuk gjejnë dëshmi pozitive se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna të rreme, me qëllim fshehjen e pasurisë. Neni D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës, sanksionon shkelje të parimeve “deklaruese”, duke parashikuar shkarkimin nga detyra për ata subjekte rivlerësimi të cilët “kanë ndërmarrë hapa për të mbuluar ose fshehur asetet”. Formulimi i këtij neni tregon qartë se, deklarimi i pasaktë është sanksionuar, për aq sa rezulton në një deklaram jo të vërtetë, duke mashtruar organet e rivlerësimit. Në rastin konkret, apartamenti është në pronësi të subjektit dhe është deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike të interesave vjetorë të vitit 2015 dhe, si rrjedhojë, nuk ka se si të ketë fshehje të pasurisë. Parashikimet e nenit D, paragrafët 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës janë të natyrës së jashtëzakonshme, sepse ato bëjnë përjashtim nga parimi gjithëpërfshirës dhe shumë i rëndësishëm kushtetues i pavarësisë gjyqësore. Këto dispozita, sipas subjektit, minimalisht duhet t’i nënshtrohen një interpretimi rreptësisht të ngushtë.

**15.1** Trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar, nëpërmjet së cilës ka interpretuar dhe shtjelluar në mënyrë shteruese kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili rregullon procedurën e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, rëndësinë vendimtare që kanë saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë. Secili nga paragrafët e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, të lidhur me rrethanat, sipas së cilave prezumohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Secila nga këto rrethana është projektuar në përcaktimet e masave disiplinore, sipas nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, duke e materializuar sanksionimin kushtetues me përcaktimin konkret të shkeljes.

Bazuar në arsyetimin e bërë më sipër, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit, ka kundërshtuar përfundimin e Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, trupi gjykues vlerëson të mbajë qëndrimin e tij në lidhje me këtë shkak ankimi në raport me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

***Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë***

16. Komisioni në vendim, lidhur me këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se: [...] subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 33, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr. 84/2016. [...]
17. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka pretenduar se Komisioni ka arritur në këtë konkluzion të gabuar, duke vlerësuar vetëm këto fakte: (i) rrethanat lidhur me jetesën e prindërve në fshat; (ii) lidhja e kontratës së shitblerjes në vitin 2012; (iii) regjistrimi i saj në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në vitin 2015, dhe jo në emër të prindërve; (iv) pamundësia financiare e vëllait të subjektit për krijimin e një sërë pasurish të paluajtshme në të njëjtën periudhë.

Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit, sikurse ka deklaruar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka parashtruar gjerësisht rrethanat familjare dhe kushtet shëndetësore të prindërve,

të cilat kushtëzuan në vitin 2012 blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>” nga vëllai i subjektit, M. L., për prindërit, pasuri e ndodhur ngjitur me apartamentin me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe, më pas, dhurimin e saj subjektit të rivlerësimit. Subjekti pretendon se këto rrethana tregojnë të kundërtën e konkluzionit të arritur nga Komisioni.

17.1 Lidhur me faktin se vëllai i subjektit nuk ka rezultuar në Shqipëri, në kohën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së dhuruar, më datë 19.06.2012, subjekti pretendon se kontrata u hartua dhe nënshkrua gjatë kohës që vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij ishin në Shqipëri, por u regjistrua në librin e veprimeve noteriale më datë 19.06.2012, në kohën kur përfunduan verifikimet e mundshme mbi pasurinë. Subjekti pretendon se dhurimi i kësaj pasurie nga i vëllai është i drejtë dhe i logjikshëm, për shkak se subjekti dhe bashkëshortja kishin vite që mbanin barrën kryesore për përkujdesjen e prindërve, në këto kushte, bashkimi i apartamentit të tij me apartamentin e dhuruar nga vëllai, do të krijonte hapësira të bollshme dhe të përshtatshme për të gjithë familjen.

17.2 Sa i përket mosregjistrimit të apartamentit në emër të prindërve, subjekti pretendon se ata kishin hequr dorë që në fillim nga pronësia e apartamentit, pasi dëshironin që apartamenti të ishte në emër të atij fëmije me të cilin ata do pleqëronin, që do të kujdesej për to, i cili në dëshirën e tyre ishte M., djali i vogël i familjes, me të cilin prindërit kishin një ekonomi të përbashkët. Subjekti i rivlerësimit pretendon se regjistrimi i kësaj pasurie në emër të vëllait, edhe pas dhurimit në emër të subjektit të rivlerësimit, nuk mbështet konkluzionin e Komisionit mbi këtë pasuri, por të kundërtën e tij.

17.3 Subjekti pretendon se, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar tej dyshimit të arsyeshëm se dhuruesi, vëllai i subjektit, ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të blerë pasurinë e dhuruar, nëse analiza financiare do të kryhej në respektim të kufijve të kryerjes së analizës financiare për personin tjetër të lidhur, sipas jurisprudencës së Kolegjit<sup>16</sup> dhe interpretimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti, në shkaqet e ankimit, ka theksuar parimin *no reformatio in peius*, të trajtuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, pra për të mbështetur dyshimin se subjekti gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji duhet të analizojë vetëm faktet mbi të cilat është mbështetur Komisioni për të dalë në këtë konkluzion.

Subjekti pretendon se analiza financiare e kryer nga Komisioni për të vëllanë e tij, duke përfshirë të gjitha pasuritë, edhe likuiditetet në bankë, ka mangësi dhe nuk paraqet situatën reale financiare. Gjendja e likuiditeteve në llogarinë e vëllait, në Deutsche Bank, më datë 20.06.2012 është në vlerën 34.515 euro dhe, ndërkohë, më datë 26.06.2012, rezulton në vlerën 4.442 euro, çka tregon se tërheqja në vlerën 30.000 euro mund të ketë shërbyer për shlyerjen e ndonjë pagese ose detyrimi të mbetur, e cila, sipas tij, mund të lidhet edhe me blerjen e kësaj pasurie, fakt ky që tregon mangësi në analizën financiare të Komisionit. Komisioni, sipas subjektit, nuk ka përfshirë në analizë të ardhurat e përfituara në mënyrë informale nga bashkëshortja e vëllait në Itali, ndërkohë që ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës për dy persona.

---

<sup>16</sup> Subjekti referon vendimin nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023, të Kolegjit, paragrafi 17.12, si dhe paragrafin 110 të vendimit nr. 15/2019 (JR), të Kolegjit.

Si argument tjetër në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti sjell faktin se në kontratën e dhurimit është përshkruar se apartamenti është blerë nga vëllai (M. L.), me kontributin sipas mundësive, edhe të dy vëllezërve të tjerë dhe motrës së tyre.

17.4 Subjekti pretendon se vëllai i tij, përveç të ardhurave të përfituara nga puna në Itali, ka përfiturar të ardhura edhe si anëtar i familjes bujqësore. Duke iu referuar të dhënave të “Raportit të vlerësimit për të ardhurat nga ullahtat dhe ferma blegtorale, dhe bletët”, të datës 16.05.2023<sup>17</sup> dhe arsyetimit të Kolegjit në vendimin nr. 20/2022 (JR), paragrafi 13.17 i tij, subjekti pretendon se metodologjia dhe dokumentacioni, që ka pasur në dispozicion ekspertja është i njëjtë me atë të subjektit të rivlerësimit, madje edhe akti i ekspertimit është bërë po nga e njëjta eksperte.<sup>18</sup> Subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur nevojë që në vitin 2012 të vendoste “apartamentin me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>” në emrin e dikujt tjetër, pasi ai ka pasur likuiditete të mjaftueshme për blerjen e tij. Komisioni duhet të kishte analizuar edhe të dhënat lidhur me deklarinimin e vendbanimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 të subjektit të rivlerësimit, dorëzuar në ILDKPKI në mars të vitit 2012, si dhe mungesën e konfliktit të interesit me dhuruesin / të vëllanë, pasi për shkak të lidhjeve familjare, nuk mund të shqyrtojë çështje ku ai është palë.

18. Nga analizimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, parashtrime dhe në seancë gjyqësore publike, si dhe akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton dhe vlerëson si vijon:

18.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Me kontratën e dhurimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2015, unë dhe bashkëshortja kemi përfiturar pronësinë mbi sipërfaqen e banimit prej 94 m<sup>2</sup>, e cila ka qenë banesa e prindërve, por e regjistruar në emër të vëllait, M. L., blerë nga motra dhe vëllezërit. (Kjo banesë ndodhet ngjitur me banesën e përshkruar në pikën “5” dhe, aktualisht i kam bashkuar në një të vetme dhe ndodhen në lagjen “{\*\*\*}” Vlorë, ku banoj aktualisht). Vlerësuar sipas çmimit të tregut në kohën e lidhjes së kontratës, në shumën prej 5.795.570 lekësh.*

Në pikën “5”, të kësaj deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2012, së bashku me bashkëshorten kanë blerë nga firma “{\*\*\*}” ShPK një apartament banimi me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> dhe një garazh me sipërfaqe 28.8 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}” Vlorë.

18.2 Së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka paraqitur *kontratë dhurimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2015, me objekt: dhurimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, lagja “{\*\*\*}”, Vlorë. Në kontratë parashikohet se dhuruesit, M. L. dhe bashkëshortja, i dhurojnë në mënyrë të pakthyeshme dhe pa asnjë lloj shpërblimi, pranuesve të*

<sup>17</sup> Subjekti, në referencë të raportit të hartuar nga ekspertja, znj. L. B., pretendon se të ardhurat e mundshme nga shitja e ullinjve deri në vitin 2002 janë në shumën 22.999.102 lekë. Të ardhurat e mundshme nga aktiviteti i blegtorisë dhe shitjes së mjalitit deri në fund të vitit 2002, janë në shumën 8.496.000 lekë. Pra, në total, deri në fund të vitit 2012, të ardhurat janë në shumën 31 milionë lekë. Ndërkohë, të ardhurat neto të familjes bujqësore deri në vitin 2012, përllogaritur sipas së njëjtës metodologji, janë në shumën 49.522.093 lekë.

<sup>18</sup> Subjekti, në këtë shkak ankimor, ngre pretendime lidhur me kuptimin dhe ndarjen në legjislacionin e zbatueshëm të rivlerësimit, të konceptit të të “ardhurave të ligjshme” dhe “burimeve të ligjshme”, duke i lidhur këto koncepte me aplikimin e nenit D, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji, në jurisprudencën e tij, është shprehur se standardi i vendosur nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, kërkon që subjekti të shpjegojë bindshëm, jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

dhurimit, subjektit dhe bashkëshortes, këtë pasuri, të vlerësuar në vlerën 5.795.570 lekë. Në kontratën e dhurimit citohet se: [...] *Pasuria objekt dhurimi, edhe pse është në pronësi të M. L. dhe E. L., është financim i vëllazërve dhe motrës së Hyrjet Lamaj. Kjo dhuratë i bëhet vëllait të tyre, Hyrjet Lamaj, e bashkëshortes së tij, E. L., për kontributin që ata kanë dhënë dhe japin për kujdesin ndaj prindërve të tyre, pasi sipas një marrëveshjeje të përbashkët, prindërit do të jenë nën kujdesin e djalit të tyre, Hyrjet Lamaj, të cilët janë kujdesur e kujdesen, duke ju krijuar kushte shumë të mira jetese, kurim e gjithçka tjetër që atyre u duhet [...]*<sup>19</sup>.

**18.3** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përfitimin e kësaj pasurie përmes kontratës së dhurimit, *ndodhur në kufi të banesës që ka në pronësi dhe banon*. Subjekti ka deklaruar që kjo banesë është kontribut i vëllazërve dhe motrës dhe se në këtë banesë kanë banuar dhe banojnë prindërit e tij.

**18.4** Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “AShK”), Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.05.2022<sup>20</sup>, ka përcjellë në Komision dokumentacionin e administruar lidhur me këtë pasuri, sipas të cilit rezulton se:

(i) Shtetasi M. L. dhe bashkëshortja e tij E. L., me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.6.2012, [shënuar me shtypshkrim: “*sot, më datë 19.06.2012 (në ditën e nëntëmbëdhjetë, të muajit qershor, të vitit 2012)*], kanë blerë kundrejt çmimit 4.982.000 lekë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”. Në kontratë referohet se çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale, me kështet e vendosura në kontratën e premtim-shitjes, legalizuar pranë zyrës noteriale, pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese. Veprimet për regjistrimin e kësaj pasurie në AShK, në emër të M. L. dhe bashkëshortes së tij, rezulton se janë kryer nga E. L., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në datën 21.06.2012.

- Nga të dhënat e sistemit TIMS, Komisionit i ka rezultuar se vëllai i subjektit, M. L., në datën 19.06.2012, kur është lidhur kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, nuk ka qenë në Shqipëri, pasi rezulton se ka hyrë në territorin shqiptar nga pika kufitare, Komisariati i Policisë Rinas, në datën 05.06.2012, dhe ka dalë po nga kjo pikë kufitare, në datën 12.06.2012.

- Ky apartament rezulton të jetë blerë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, një ditë më vonë se apartamenti me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, i blerë dhe në pronësi të subjektit të rivlerësimit, nga e njëjta shoqëri ndërtimore dhe në të njëjtin kat (ngjitur) me apartamentin ku jeton subjekti.

(ii) Me urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 08.02.2016, të regjistruesit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, është bërë bashkimi në një pasuri të re, me sipërfaqe 164 m<sup>2</sup>, me nr. {\*\*\*}, në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes, i dy pasurive, konkretisht: (1) “apartamenti me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, me nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, dhuruar subjektit me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2015, është bashkuar me: (2) “apartamentin me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>”, me nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, të subjektit të rivlerësimit.

**18.5** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 02.11.2022, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me origjinën, burimin e ligjshëm të të ardhurave, datën e blerjes, faktit se kush ka jetuar në këtë apartament, mbi shpenzimet e kryera për arredimin dhe për bashkimin e dy apartamenteve në një të vetëm, ndër të tjera ka deklaruar se: [...] *Apartamenti është blerë prej tij, (vëllait) [...] në vlerën 4.982.000 lekë, me kontribut sipas mundësive edhe të vëllazërve M.*

<sup>19</sup> Bashkëlidhur, certifikatë për vërtetim pronësie, në emër të M. dhe E. L., lëshuar më datë 28.06.2012.

<sup>20</sup> Edhe shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2023.

dhe E. L., si dhe së motrës V. H. (L.), të cilët vlerësonin / dëshironin të kontribuonin për banesën, ndërsa unë të përkujdesesha për jetesën e tyre në vazhdim. Në dijeninë time, ndërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. M. L., nuk ka kontratë premtim-shitje për këtë banesë. Ajo është blerë për të jetuar prindërit, të cilët në këtë kohë jetonin në fshatin Trevllazër – Vlorë dhe, më pas, kanë ardhur dhe jetuar në këtë banesë. Ky apartament është blerë prej vëllait tim, në afërsi të banesës time. M., si vëlla i vogël, kishte prindërit në ngarkim, por jetonte në Itali dhe të gjitha të ardhurat që prindërit grumbullonin mbas largimit tim nga familja (në muajin gusht të vitit 2002) ia kalonin vëllait, M. L.. Gjatë kësaj kohe, unë jam kujdesur për prindërit, duke i ndihmuar ata, në vlera monetare modeste, përkujdesje, interesim, shërbime etj.

Shpenzimet për mobilimin e kësaj banese janë kryer prej vëllait, pasi siç e shpjegova, edhe më lart, ai ka pasur një ekonomi familjare të përbashkët me prindërit. Në lidhje me shpenzimet, nuk kam dijeni [...] Shpenzimet e kryera nga ana ime për bashkimin e këtyre apartamenteve kanë qenë jo në vlerën e deklarimit, kanë qenë të vogla, për shkak se apartamentet kanë qenë ngjitur me njëri-tjetrin. [...]

- Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait për blerjen e pasurisë së dhuruar, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, subjekti ka dorëzuar: (1) formularët CUD, të lëshuar nga shteti italian për të ardhurat e përfituara nga punësimi i vëllait për periudhën 2002 – 2009; (2) deklarata e znj. L. T., e ngarkuar për përgatitjen dhe transmetimin e deklaratave të të ardhurave të z. M. L., për periudhat tatimore 2010 – 2012; (3) Ekstrakt i llogarisë bankare në “Deutsche Bank”, i M. L., për muajt dhjetor 2010, tetor – dhjetor 2011 dhe tetor – dhjetor 2012.

**18.6** Nga sa më sipër, Komisionit i ka rezultuar se vëllai i subjektit, për periudhën 2002 – 2012, ka realizuar të ardhura nga punësimi (neto),<sup>21</sup> në shumën totale 236.915 euro dhe, duke u zbritur të ardhurave më sipër, shpenzimet e jetesës për një person<sup>22</sup>, në vlerën 89.744 euro, rezulton balancë pozitive në vlerën 147.172 euro.

**18.6.1** Trupi gjykues i Kolegjit, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se vëllai i subjektit, për periudhën 2002 – 2012, ka përfiturar të ardhura neto (të ardhurat bruto – tatimin mbi të ardhurat + taksën rajonale + komunale) në vlerën 236.446 euro. Trupi gjykues konstaton se, në formularin e CUD, për periudhën 2002 – 2009, në seksionin 3: *Kontribute në ngarkim të punëtorit, të mbajtura*, rezulton edhe vlera e paguar për kontributet e sigurimeve shoqërore. Komisioni, në përlllogaritjen e të ardhurave neto, nuk ka zbritur kontributin e sigurimeve shoqërore, si rrjedhojë, trupi gjykues, për të mos rënduar situatën financiare të vëllait të subjektit, nga vlera e të ardhurave bruto, ashtu si Komisioni, ka zbritur vetëm vlerën e tatimit, por në rast se do të zbritej edhe vlera e kontributit të paguar, të ardhurat neto do të përlllogariteshin në vlerën 221.370 euro.

**18.7** Nga ekstrakti i llogarisë bankare në Deutsche Bank, për muajt dhjetor 2010, tetor – dhjetor 2011 dhe tetor – dhjetor 2012, Komisioni ka konstatuar se vëllai i subjektit ka pasur gjendje

---

<sup>21</sup> Komisioni ka referuar se subjekti ka paraqitur formularët “CUD”, Itali, lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi për periudhën 2002 – 2012. Të ardhurat e përfituara për periudhën 2010 – 2012 i referohen të ardhurave bruto dhe, për këtë periudhë, tatimi është llogaritur në nivelin 16%, referuar raportit të krijuar nga tatimi i paguar mbi të ardhurat e përfituara për periudhën 2003 – 2009.

<sup>22</sup> Në analizën fillestare të kryer për mundësinë e krijimit vetëm të pasurisë apartament 94 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2012 dhe më pas dhuruar subjektit në vitin 2015, Komisioni ka përlllogaritur, si të ardhurat, ashtu dhe shpenzimet, vetëm për të vëllanë e subjektit, z. M. L.

likuiditeti në llogari në fund të çdo viti. Në datën 20.06.2012, pas blerjes së apartamentit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, ka pasur gjendje likuiditeti në llogari, në vlerën 34.515 euro.

**18.7.1.** Trupi gjykues, nga ekstrakti i llogarisë bankare në Deutsche Bank, konstaton se deri më datë 17.06.2012, para datës së blerjes së pasurisë, rezulton të ketë pasur gjendje 34.645 euro. Në kontratën noteriale të shitblerjes së kësaj pasurie, të datës 19.06.2012, në dispozitën *Çmimi dhe mënyra e pagesës*, parashikohet se *çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale*<sup>23</sup>, ndërkohë që pakësimi në këtë llogari daton pas datës së lidhjes së kontratës, përkatësisht në datat 22 dhe 26 qershor 2012. Bazuar në nenin 690 të Kodit Civil, sipas të cilit, kontrata e lidhur rregullisht ka fuqinë e ligjit për palët, në kushtet kur nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor që të provojë se palët, me pëlqim të ndërsjellë, janë dakordësuar për ndryshimin e saj, duke parashikuar një mënyrë të ndryshme për pagesën e çmimit të kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se shuma gjendje, në Deutsche Bank, nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e pasurisë “apartament me sip. 94 m<sup>2</sup>”, sikurse pretendon subjekti në shkaqet e ankimit.

**18.8** Nga informacioni i përcjellë në Komision nga AShK-ja, rezulton se vëllai i subjektit (M. L. dhe bashkëshortja), përveç apartamentit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, dhuruar subjektit të rivlerësimit, blerë më datë 19.06.2012, po ashtu ka blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.06.2012, edhe dy apartamente të tjera dhe një garazh, konkretisht: (1) apartament me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, në vlerën 3.922.000 lekë; (2) apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.982.000 lekë; dhe (3) garazh me sipërfaqe 24.5 m<sup>2</sup>, në vlerën 908.950 lekë; në total në vlerën 9.812.950 lekë, shumë e cila, sipas përcaktimeve në kontratë, *është likuiduar jashtë zyrës noteriale, me këstet e vendosura në kontratën e premtim-shitjes, pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese*. Nga aktet, ka rezultuar se këto dy apartamente janë bashkuar në një apartament të vetëm, me sipërfaqe 168 m<sup>2</sup>. Komisionit, nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS, i ka rezultuar se vëllai i subjektit nuk ka qenë në Shqipëri në datën e nënshkrimit të blerjes së pasurisë me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, dhuruar më pas subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar se ai dhe bashkëshortja kanë qenë në Shqipëri në datën 11.06.2012, kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes për blerjen e tri pasurive të mësipërme.

**18.9** Gjatë hetimit administrativ, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “OShEE”) ka informuar Komisionin<sup>24</sup> se, në objektin e banimit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përveç kontratës së furnizimit me energji elektrike nr. {\*\*\*}, të lidhur për pasurinë e blerë nga vetë subjekti i rivlerësimit me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> (apartamenti me nr. {\*\*\*}), në emër të tij figuron edhe një kontratë tjetër furnizimi, përkatësisht me nr. {\*\*\*}, e cila i përket apartamentit ngjitur, me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup> (apartamenti me nr. {\*\*\*}), dhuruar nga i vëllai. Sipas akteve të administruara, rezulton se të dy kontratat janë hapur në datën 30.11.2011, si fillim në emër të shtetases N. M. dhe, në datën 12.02.2016, është bërë ndryshimi i emrit të abonentit, te subjekti i rivlerësimit, me përshkrimin: *ndryshim emri me kalim pronësie, ku pronari më i ri i objektit*

<sup>23</sup> Kjo dispozitë parashikon shprehimisht se “është likuiduar jashtë zyrës noteriale, me këstet e vendosura në kontratën e premtim-shitjes. Legalizuar pranë zyrës time noteriale, pa asnjë pretendim nga pala kontraktuese”. Megjithëse kontrata e shitblerjes i referohet ekzistencës së një kontrate premtim shitjeje, e cila nuk u dokumentua gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, se një kontratë e tillë nuk është lidhur dhe se ky formulim ka mbetur si model standard, i përdorur në aktin noterial, rrethanë e konfirmuar edhe nga deklaratat noteriale e përfaqësuesit të shoqërisë shitëse.

<sup>24</sup> Referohuni shkresës nr. {\*\*\*}, datë, 21.09.2020 dhe shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 08.02.2023.

*kërkon të marrë pronësinë e kontratës së energjisë elektrike, e cila rezulton në pronësi të një personi të mëparshëm, i cili nuk është shitësi direkt i objektit.*

**18.10** Referuar të dhënave të përcjella në Komision nga Ujësjellës-Kanalizime ShA, Vlorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.11.2022, rezulton se në listën emërore, përcjellë në këtë institucion nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në sistemin e faturimit janë kryer pagesa utilitetesh për një apartament të tipit “3+1”, të përbërë nga apartamentet me nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, të cilat i referohen, përkatësisht apartamentit me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> të blerë nga subjekti dhe, i dyti, apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, blerë nga vëllai i tij (dhuruar subjektit në vitin 2015). Po në këtë listë emërore, rezulton se në emër të babait të subjektit, V. L., janë kryer pagesa utilitetesh, për një apartament të tipit “3+1”, të përbërë nga apartamentet me nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, që duket se korrespondojnë me dy apartamentet e blera nga vëllai i subjektit, M. L..

**18.11** Po ashtu, OShEE ka informuar Komisionin se në emër të babait të subjektit rezulton kontratë furnizimi me energji elektrike, me vendndodhje në fshatin Novoselë, Vlorë, e hapur në datën 08.07.2004. Sipas sistemit të faturimit, për këtë kontratë rezulton se: (i) për periudhën janar 2007 – dhjetor 2012, ka pasur konsum të energjisë elektrike; (ii) për periudhën janar 2013 – gusht 2013, nuk ka pasur konsum të energjisë elektrike; (iii) për periudhën shtator 2013 e në vijim, ka pasur konsum të energjisë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka informuar Komisionin se prindërit e subjektit rezultojnë të regjistruar si banorë në Njësinë Administrative Novoselë, Vlorë, prej vitit 1974 e aktualisht.

**18.12** Nga informacioni i administruar në Komision nga Intesa Sanpaolo Bank<sup>25</sup> dhe Raiffeisen Bank<sup>26</sup>, rezulton se z. V. L. dhe z. M. L. kanë qenë bashkëmbajtës të dy llogarive bankare në monedhën euro. Konkretisht, në Banca Italo-Albanese (aktualisht Intesa Sanpaolo Bank) rezulton se në dhjetor 2006, gjendja në llogarinë dyemërore ka qenë në vlerën 27.000 euro dhe në dhjetor 2007 ka qenë në vlerën 52.000 euro. Në datën 10.03.2009, kjo llogari dyemërore është mbyllur. Ndërkohë, në Raiffeisen Bank rezulton se, në dhjetor 2006, gjendja në llogarinë dyemërore ka qenë në vlerën 41.978 euro. Në datën 02.03.2007, me fondet e përfituara nga maturimi i depozitës, është kryer një transfertë në vlerën 42.582 euro, në llogarinë personale të z. V. L., me përshkrimin: *kalim fondi në llogari një emërore*. Llogaria dyemërore është mbyllur më datë 01.11.2007.

**18.13** Gjithashtu, rezulton se shtetasi M. L. ka disponuar edhe llogari bankare personale në Raiffeisen Bank dhe Bankën Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”)<sup>27</sup>. Në llogarinë personale në Raiffeisen Bank, për periudhën 22.07.2011 – 22.07.2012, rezulton depozitë me vlerë 24.245 euro dhe në llogarinë personale në BKT, më datë 25.07.2011 ka investuar në një depozitë me vlerë 20.000 euro.

**18.14** Komisioni ka përgatitur analizë financiare lidhur me mundësitë e vëllait të subjektit, M. L., për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, me vlerë 4.982.000 lekë, më datë 19.06.2012. Nga analiza, duket se shtetasi M. L. dispononte likuiditete bankare dhe të ardhura financiare të konsiderueshme për të blerë vetëm këtë pasuri. Megjithatë, Komisioni ka arsyetuar se, nëse në

---

<sup>25</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.09.2020.

<sup>26</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2020.

<sup>27</sup> Përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.03.2023.

analizë merren në konsideratë të ardhurat e tij, të dokumentuara deri në atë moment, së bashku me investimet e kryera për blerjen edhe të tri pasurive të paluajtshme në datën 11.06.2012, në total në vlerën 70.233 euro (9.812.950 lekë) <sup>28</sup>, si dhe mundësia për krijimin e likuiditeteve bankare dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës, duket se ai nuk ka mundësi financiare për të blerë edhe pasurinë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, të cilën ia ka dhuruar subjektit në vitin 2015, pasi rezulton në pamundësi financiare, në shumën (-) 44.522 euro, për krijimin e pasurive të tij dhe likuiditeteve.

**18.15** Nisur nga sa më sipër rezultuar mbi pamundësinë financiare të vëllait të subjektit – si dhe në konsideratë të fakteve se kontrata e shitblerjes së pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, dhuruar subjektit të rivlerësimit: (i) është nënshkruar më datë 19.06.2012, një ditë pas blerjes nga ana e subjektit më datë 18.06.2012, të pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>” dhe, më pas, bashkuar në një të vetme; (ii) vëllai i subjektit, M. L., nuk ka qenë në Shqipëri ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate; (iii) veprimet për regjistrimin e pasurisë në emër të M. L. janë kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, E. L., në datën 21.06.2012 – Komisioni ka ngritur dyshime se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, pasi nga hetimet duket sikur kjo pasuri është krijuar që prej fillimit, nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si dhe i ka kërkuar të paraqesë foto të apartamentit me sipërfaqe 164 m<sup>2</sup> në pronësi të tij dhe apartamentit me sipërfaqe 168 m<sup>2</sup>, në pronësi të vëllait të tij.

**18.16** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ashtu sikurse edhe në shkaqet e ankimit dhe në seancë gjyqësore publike, ka deklaruar se: [...] *Për pikën e parë të barrës, sqaroj se, në deklaratën vetting kam deklaruar se kjo pasuri ka qenë banesë e prindërve, por e blerë nga vëllezërit e motra dhe e regjistruar në emër të vëllait, M. L.. Në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, M. kishte prenotuar, në vitin 2011, dy apartamentet dhe garazhin. Nëse i referohemi shkresës së konfirmuar nga UKT, nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2022, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK kishte dhënë emrat e blerësve, duke përfshirë edhe emrin e babait, V. I. L., pasi kishte qenë babai personi që kishte kryer pagesën për blerjen e pasurive të porositura nga M.. Në vitin 2012, unë erdha në dijeni se N. M. ishte tërhequr nga blerja e dy pasurive të porositura prej saj në shoqërinë “{\*\*\*}” në të njëjtin pallat që vëllai kishte porositur dy apartamentet e tij. Në bisedë me M., vendosëm që unë do të blija një apartament dhe apartamentin tjetër ngjitur do ta blinte ai për prindërit, me qëllim që unë të kujdesesha në mënyrë të vazhdueshme për ta. [...] Meqenëse M. do largohet, u paraqit në datën 12.06.2012 te noteri, me qëllim që, së bashku me H. të nënshkruanin kontratën e shitblerjes për pasurinë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”. [...] Pasi janë kryer verifikimet, dhe pasi në kontratën e përpiluar paraprakisht ka nënshkruar edhe bashkëshortja e M., më datë 19.06.2012 është regjistruar kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.06.2012, me palë shitëse firmën “{\*\*\*}” ShPK, për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, kundrejt çmimit 4.982.000 lekë, në regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale. [...] Gjithashtu, pasi noterja ka kryer verifikimet për kartelën e pasurisë, dhe unë dhe bashkëshortja, kemi nënshkruar kontratën e shitblerjes më datë*

---

<sup>28</sup> Konkretisht, (i) apartamentit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, me vlerë 4.982.000 lekë (35.657 euro); (ii) apartamentit me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, me vlerë 3.922.000 lekë (28.070 euro) ; si dhe, (iii) garazhit me sipërfaqe 24.5 m<sup>2</sup>, me vlerë 908.950 lekë (6.506 euro).

18.06.2012. Për dy apartamentet e sipërcituara, “{\*\*\*}” ShPK kishte lidhur dy kontrata uji në emër të N. M., atë me nr. {\*\*\*} dhe kontrata tjetër e apartamentit, me nr. {\*\*\*}. Në momentin e blerjes së apartamentit nga ana ime, dhe blerjes nga vëllai, M. L., të apartamentit që do të qëndronin prindërit, nuk kam bërë ndryshim të kontratave të ujit (për arsye neglizhence dhe të procedurave burokratike të zgjatura), të cilat realisht janë dy. Detyrimet e shërbimeve utilitare për të dy apartamentet janë kryer nga ana ime, për shkak se në apartamentin tjetër jetonin prindërit dhe unë kujdesesha për ta. Në deklaratë pasurie, kam deklaruar shpenzime për prindërit, shpenzime në të cilat përfshihen edhe shpenzimet për shërbimet utilitare. Këto dy apartamente kanë pasur faturim të ndryshëm, sipas kontratave me nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, të cilat, në vitin 2016, me sa kujtoj, janë ndryshuar nga emri i N., në emrin tim. Edhe sot e kësaj dite, ka dy faturime të energjisë elektrike, sipas dy kontraktorëve të cilët u përkasin apartamenteve të ndryshme të vitit 2012, bashkimi i së cilëve kërkon ndërhyrje në strukturë të objektit.

Së dyti, bashkëshortja ime ka qenë punonjëse në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe veprimet për regjistrimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, në emër të shtetasit M. L., janë kryer prej saj si punonjëse e ZRPP-së, ashtu si ajo ka kryer në këtë periudhë dhjetëra regjistrime për shtetas të tjerë. [...] Së treti, është e pabazuar gjetja e Komisionit, se kam pasur në përdorim apartamentin e blerë nga vëllai qysh prej fillimit të krijimit. i) Këto pasuri janë porositur dhe poseduar fillimisht nga shtetasja N. M., e cila është larguar pasi kishte restauruar shtëpinë e vjetër të banimit, gjatë periudhës që ne kemi nënshkruar kontratën e shitblerjes. Me blerjen e truallit, ajo vendosi të bëjë rikonstrukcion të banesës së vjetër dhe të heqë dorë nga apartamentet e porositura. ii) Komisioni ka hetuar në lidhje me konsumin e energjisë elektrike në banesën në fshatin Trevllazër, Vlorë. Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se për periudhën janar 2013 – gusht 2013 nuk ka pasur konsum të energjisë elektrike, për periudhat, si para janar 2013, ashtu edhe pas gushtit 2013, ka pasur konsum të energjisë elektrike. Në banesën në fshat ka jetuar dhe vazhdon të jetojë vëllai, E. dhe bashkëshortja e tij, Sh., me tre fëmijët e tyre. Për këtë arsye, konsumi i energjisë elektrike ka qenë i vazhdueshëm, përveç 8-mujorit të parë të vitit 2013. iii) Komisioni, gjatë hetimit administrativ, më ka kërkuar të paraqisja dokumentacion provues për të ardhurat e vëllait, M. L.. Duke marrë shkas nga fakti se vëllai M. L. ka dhuruar apartamentin me sip. 94 m<sup>2</sup>, në respekt të dispozitave ligjore të ligjit 84/2016, kam menduar se vëllai do të cilësohej person tjetër i lidhur. Nisur nga praktika tashmë e konsoliduar e Kolegjit në lidhje me provueshmërinë e të ardhurave të ligjshme të personit tjetër të lidhur, kam paraqitur dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat e realizuara nga vëllai. Në fakt, Komisioni ka kryer analizën financiare për të gjitha pasuritë e vëllait tim, M. L., ndërkohë që tashmë jurisprudenca e Kolegjit në këtë drejtim është e konsoliduar, duke filluar që nga vendimi 15/2015. Më tej, ky qëndrim është elaboruar në vendimin e fundit, nr. 2, datë 02.02.2023. [...] Si konkluzion, analiza financiare e kryer nga Komisioni është shtrirë përtej përcaktimeve ligjore të kërkuara për personin tjetër të lidhur. Kjo analizë do pasqyronte situatën reale financiare të vëllait, M. L., vetëm nëse do kryhej një hetim i plotë dhe i thellë në lidhje me situatën ekonomike të vëllait, M. L., hetim i cili nuk është i parashikuar në ligj dhe shkon përtej parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe qëllimit që nxiti kryerjen e reformës në sistemin e drejtësisë. Për këtë arsye, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit [...], kërkoj që analiza e vëllait, M. L., të kryhet vetëm për pasurinë që më ka dhuruar. [...] Konkluzioni i Komisionit nuk qëndron edhe për shkak të faktit se mungon qëllimi dhe arsyeja e kryerjes së një veprimi të tillë. Në datën e blerjes së pasurisë, rezultoi se

*unë kam pasur mundësi financiare, në shumën 4.982.000 lekë, për të blerë apartamentin. Dyshimi i kryerjes së një veprimi të tillë do të përlligjej, në rast të mungesës së disponimit të vlerës së apartamentit, për të shmangur transaksionin dhe paraqitur atë në një moment tjetër kohor. Analiza financiare kryer nga Komisioni tregon të kundërtën. Referuar deklaratës vetting, rezulton se unë kam dhënë borxh pa interes, shumën prej 5.900.000 lekësh, të cilën vazhdoj ta disponoj edhe sot. [...]*

Në mbështetje të prapësimeve, subjekti ka paraqitur foto të dy pasurive të verifikuara nga Komisioni, si dhe aktet në vijim:

(1) Deklaratë personale e noteres S. H., datë 27.02.2023, e cila, ndër të tjera, deklaron se: *[...] Pasi kam kryer verifikimet në arkivin noterial, në regjistrin elektronik e indeksat e të gjithë periudhës para nënshkrimit të kontratës, nuk rezulton kontratë premtim-shitje midis shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. Hyrjet dhe E. L. Për sa më sipër, mbaj të gjitha përgjegjësitë që njeh ligji në këto raste. [...]*

(2) Deklaratë e noteres S. H., datë 19.05.2023, e cila shpjegon procedurën e nënshkrimit të kontratës së datës 19.06.2012 dhe, ndër të tjera, deklaron se: *Pasi kam redaktuar kontratën, kanë firmosur H. Xh. dhe M. L., i cili do largohet ato ditë nga Shqipëria. Për sa i përket bashkëshortes së tij, ajo do vinte për të nënshkruar më vonë, ndërkohë gjatë kësaj kohe, më duhej të verifikoja kartelën e pasurisë së paluajtshme, objekt i kësaj kontrate [...] duke shkuar personalisht në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Theksoj faktin se, duke qenë se njoh të dyja palët dhe kam lidhje me ta, mbaj mend shumë mirë çdo detaj lidhur me këtë situatë kontraktore. [...] Për shkak të kohës dhe rregullimit praktik dhe ligjor të saj, kanë ndodhur regjistrimi i kontratës në datën 19.06.2012.*

(3) Akti i ekspertimit grafik të nënshkrimeve, nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2023, sipas të cilit rezulton se nënshkrimet në emër të M. L., që gjenden në dy ekzemplarët e dokumentit “Kontratë banimi”, me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 19.06.2012, janë shkruar nga i njëjti person dhe gjithashtu janë nënshkruar nga M. L., krahasuar me modelet e paraqitura në emër të M. L..

**18.17** Komisioni, në përfundim, vlerësoi se: *[...] rrethanat e rezultuara gjatë hetimit [...] krijuan bindjen se apartamenti me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, me palë shitëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, është pasuri e subjektit të rivlerësimit e se ai ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues vlerëson se nuk mund të bëjë analizën e burimeve të vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit M. L., në mënyrë të veçuar dhe mbështetur vetëm në pasurinë e krijuar për subjektin e rivlerësimit, pasi në tërësi, situata e krijuar në vitin 2012 mbart në vetvete dyshime, dhe se këto pasuri janë krijuar thujse në të njëjtën periudhë kohore, ndaj një analizë e shkëputur nuk do të pasqyronte situatën reale dhe nuk do t’u jepte përgjigje dyshimeve të Komisionit lidhur me këtë pasuri. Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr. 84/2016. [...]*

**18.18** Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni e ka bazuar konkluzionin e tij vetëm në: (i) rrethanat e konstatuara mbi jetesën e prindërve të subjektit në fshat; (ii) vitin e lidhjes së kontratës së pasurisë së apartamentit; (iii) regjistrimin e saj në emër të subjektit; dhe, (iv) pamundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit – trupi gjykues i

Kolegjit konstaton se Komisioni ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për pasurinë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015.

**18.19** Trupi gjykues i Kolegjit analizoi vendimin e Komisionit, faktet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, rrethanat e blerjes dhe arsyet e pretenduara nga subjekti për dhurimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, duke i vlerësuar ato në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën, si rezultat i një procesi logjik drejt përcaktimit të besueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, në drejtim të zbatimit të parashikimeve të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar me peshë për verifikimin e mënyrës së krijimit të kësaj pasurie, rrethanat dhe faktet si vijojnë:

**18.19.1** *Së pari*, rezulton që pasuria objekt dhurimi është blerë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, M. L., më datë 19.06.2012, në vlerën 4.982.000 lekë, një ditë pasi subjekti i rivlerësimit kishte blerë, më datë 18.06.2012, nga e njëjta shoqëri ndërtimore, në të njëjtin kat dhe në kufi me këtë pasuri, një apartament me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, ndërkohë që vëllai i subjektit, në datën 11.06.2012, kishte blerë dy apartamente të tjera dhe një garazh në të njëjtën ndërtesë, në total në vlerën 9.812.950 lekë.

Nga të dhënat e sistemit TIMS, ka rezultuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit, M. L., në datën 19.06.2012, kur është lidhur kontrata e shitblerjes së apartamentit të dhuruar, nuk ka qenë prezent në Shqipëri. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata ka qenë e nënshkruar prej vëllait përpara se ai të largohej nga Shqipëria dhe, më tej, noterja ka bërë regjistrimin e saj në datën 19.06.2012, në përfundim të verifikimit lidhur me këtë pasuri, u vlerësua si i pabesueshëm nga trupi gjykues, në konsideratë të të dhënave të referuara në përmbajtjen e kontratës dhe mënyrës së pasqyrimin të këtyre të dhënave në të. Rezulton se data 19.06.2012, kur është lidhur kontrata e shitblerjes mes të vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtimore, në pjesën hyrëse të saj është shënuar me shtypshkrim, *sot, më datë 19.06.2012 (në ditën e nëntëmbëdhjetë, të muajit qershor, të vitit 2012)*, firmosur në çdo faqe, që nënkupton dhe provon se ajo është nënshkruar nga palët, pikërisht në këtë datë, në të cilën M. L. rezulton të mos të ketë qenë në Shqipëri. Pretendimet e subjektit dhe shpjegimet e noteres në deklaratën noteriale të lëshuar prej saj do të merrnin kuptim nëse data e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes do të ishte plotësuar me shkrim dore, në momentin kur finalizoheshin të gjitha verifikimet përkatëse në kartelën e kësaj pasurie para finalizimit të saj (megjithëse edhe ky veprim duket i pakuptimtë që të jetë kryer nga noterja, pasi është firmosur paraprakisht nga një prej “bashkëpronarëve”, z. M. L.). Në këto kushte, trupi gjykues konsideroi si të pabesueshme pretendimet e subjektit të rivlerësimit, deklaratimet noteriale të vëllait të tij, por edhe të noteres, e cila ka përpiluar aktin për këtë veprim juridik, sa i përket qartësisë dhe saktësisë *kronometrike* të parashikimit ekzaktësisht në kontratë, të momentit kur do të përmbylleshin nënshkrimi nga bashkëshortja e z. M. L. dhe verifikimet përkatëse në të ardhmen, pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pra datën 19.06.2012.

*Së dyti*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, së bashku me të vëllanë ishin dakordësuar që dy apartamentet ngjitur me njëri-tjetrin, prej të cilëve znj. N. M. (motra e bashkëshortes) kishte hequr dorë, të bliheshin njëri nga subjekti i rivlerësimit dhe tjetri nga i vëllai i tij, për prindërit, me qëllim që subjekti t'i kishte afër dhe të kujdesej në mënyrë të vazhdueshme për ta. Të dy

apartamentet, si ai i blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe ai i dhuruar nga i vëllai, më pas, me urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 08.02.2016, të regjistruarit të ZVRPP-së Vlorë, janë bashkuar në një pasuri të vetme, me sipërfaqe 164 m<sup>2</sup>, e cila që prej fillimit, ka qenë vetëm në posedim të subjektit të rivlerësimit<sup>29</sup>. Pavarësisht pretendimeve, në kundërshtim të barrës së provës, si më sipër referuar, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë, që të dokumentojë të kundërtën.

**18.19.2** Trupi gjykues i Kolegjit, për sa më sipër, vlerëson si jopërcaktuese rrethanat familjare dhe shëndetësore të prindërve, të cilat u pretenduan nga subjekti i rivlerësimit, se kanë kushtëzuar blerjen e kësaj pasurie nga i vëllai dhe, më pas, dhurimin e saj te subjekti i rivlerësimit. Për këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe rrethanat e pasqyruara në vendimin e Komisionit, nga rezulton se të gjitha pasuritë, veprimet me karakter pasuror të subjektit, për të cilat i ka kaluar barra e provës, burimet financiare për krijimin e tyre, si dhe transaksionet e deklaruara nga ai, lidhen me persona që ndodhen në marrëdhënie familjare me të ose bashkëshorten e tij.<sup>30</sup> Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerëson se rrethanat familjare të pretenduara nga subjekti për të shpjeguar transaksionin konkret të dhurimit të pasurisë, nuk paraqiten si elemente të veçuara, por si pjesë e një modeli të përsëritur marrëdhëniesh pasurore, ku krijimi i pasurive, burimet financiare të deklaruara për to dhe transaksionet e mëvonshme, rezultojnë të jenë të lidhura pothuajse në çdo rast me persona të rrethit familjar.

*Së treti*, trupi gjykues vlerëson se blerja e një apartamenti të tretë nga vëllai<sup>31</sup>, me qëllim që në të të jetonin prindërit e, më pas, dhurimi i tij te subjekti i rivlerësimit, duken si transaksione të panevojshme dhe jo të logjikshme, në kushtet kur vëllai, z. M. L., kishte blerë dy apartamente të tjera, vetëm tetë ditë më parë, në datën 11.06.2012, të cilat, nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, nuk rezultojnë të jenë përdorur prej tij apo prej të tretëve, gjë që provohet edhe nga mungesa e konsumit të energjisë elektrike, sipas të dhënave të OShEE-së. Pasja e një ekonomie të përbashkët familjare të vëllait me prindërit, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit, logjikisht dikton përdorimin e përbashkët edhe të pasurive të paluajtshme që disponojnë anëtarët e familjes (sikurse është pretenduar nga subjekti për përdorimin e tokës bujqësore dhe frutet e saj) dhe e bën të pabesueshëm këtë pretendim të subjektit.

Nëse do të ndiqej logjika e prezantuar nga subjekti i rivlerësimit, prindërit e tij kishin mundësinë për të përdorur dy apartamentet e tjera, me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, dhe garazh me sipërfaqe 24.5 m<sup>2</sup>, të blerë në datën 11.06.2012 nga z. M. L., në total, në vlerën 9.812.950 lekë, të cilat gjendeshin një kat më sipër apartamentit të subjektit, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë këtij të fundit që të kujdesej për ta, pa qenë i nevojshëm investimi / shpenzimi nga vëllai (por, edhe nga vëllezërit e tjerë dhe motra, siç ka pretenduar subjekti) në një apartament të tretë, i cili, më pas, iu dhurua atij.

Për më tepër, nga aktet e administruara nuk rezulton asnjë rrethanë objektive, që të krijojë

---

<sup>29</sup> *Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar se detyrimet e shërbimeve utilitare për të dy apartamentet janë kryer nga ana e tij, ndërkohë që edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk u provua jetesa e vazhdueshme prindërve në këtë apartament.*

<sup>30</sup> *Trupi gjykues mban në konsideratë rrethanat mbi pasurinë fillestare të deklaruar si të dhuruar nga babai, pasurinë në vitin 2012, të ndarë në dy pasuri të veçanta, shitur nipit të tij dhe mbesës së bashkëshortes dhe, më pas, të ardhurat e deklaruara si burim për apartamentin me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, dhe huan dhënë kunatit sipërmarrës.*

<sup>31</sup> *Pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se është blerë edhe me kontributin e familjarëve të tjerë, por i pambështetur në dokumentacion provues.*

bindjen se pasuria në fjalë është blerë për nevojat e strehimit të prindërve. Përkundrazi, vendndodhja e saj ngjitur me apartamentin e subjektit të rivlerësimit, si dhe mungesa e provave që prindërit ta kenë përdorur ndonjëherë këtë pasuri, përbëjnë elemente që tregojnë se përfituesi faktik i saj ka qenë vetë subjekti. Kjo bindje përforcohet edhe nga fakti si më sipër referuar, për zotërimin nga vëllai edhe të dy hyrjeve të tjera në të njëjtën godinë. Në këto kushte, pretendimi se blerja e pasurisë është diktuar nga nevojat familjare dhe shëndetësore të prindërve mbetet i pambështetur në prova dhe nuk gjen mbështetje në rrethanat objektive të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

Sa më sipër, përkundrejt pretendimeve të subjektit, se vëllai dhe prindërit kishin ekonomi të përbashkët dhe pasuria u ble për prindërit, në vlerësim të trupit gjykues, regjistrimi i kësaj pasurie vetëm në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit në vitin 2012 dhe, më pas, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, pas dhurimit në vitin 2015 dhe jo në emër të prindërve, nuk është rrjedhë logjike e qëllimit për të cilin pretendohet se u krye ky investim.

**18.19.3** *Së katërti*, në vijim të arsyetimit të mësipërm, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nga aktet e zyrës së gjendjes civile, administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, rezultoi e provuar se prindërit e subjektit kanë jetuar dhe jetojnë në fshatin Trevllazër, Novoselë, Vlorë. Sipas sistemit të faturimit të OShEE-së, në banesën e tyre në fshat, rezultoi konsum i vazhdueshëm i energjisë elektrike për periudhën janar 2007 – dhjetor 2012 dhe për periudhën shtator 2013 e në vijim, duke mbetur në nivel deklarativ pretendimi se prindërit kanë jetuar së bashku me subjektin e rivlerësimit, në apartamentin e dhuruar nga vëllai, M. L.. Të dhënat e OSHEE-së mbi konsumin e energjisë elektrike në banesën e prindërve në Novoselë, si dhe regjistrimi i tyre i pandërprerë në gjendjen civile në këtë njësi administrative, dokumentojnë se ata kanë vijuar të jetojnë në Novoselë dhe jo në pasurinë objekt dhurimi. *Së pesti*, lidhur me shkakun ankimor, mbi kufijtë e verifikimit dhe kontrollit të pasurisë të subjekteve të rivlerësimit, kur ata gjenden para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, ndonëse jurisprudenca e Kolegjit<sup>32</sup> ka pranuar se analiza e pasurisë së personave të tjerë të lidhur, duhet të kryhet në mënyrë proporcionale dhe, në parim, brenda kufijve të pasurisë së dhënë hua apo dhuruar, ky standard nuk mund të kufizojë apo pengojë organet e rivlerësimit në ushtrimin e detyrimit kushtetues për të hetuar rrethana objektive, që krijojnë dyshime për fshehje pasurie, deklarim të rremë apo paraqitje të pasaktë të marrëdhënieve pasurore dhe burimit real të krijimit të tyre. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>33</sup>, i cili mban në konsideratë se analiza dhe vlerësimi i pasurisë shkon përtej kufijve të pasurisë së dhuruar, në rastet e ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura të subjekteve të rivlerësimit, në emër të personave të tjerë, në rastin konkret, në momentin e krijimit *de facto* të saj.

**18.19.4** Për shkak të rrethanave të trajtuara më sipër dhe në drejtim të krijimit të bindjes lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni, për mundësinë e të vëllait të subjektit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasurinë objekt kontrolli, bazuar në qëndrimet e mësipërme. Lidhur me të hyrat në likuiditete bankare nga vëllai i subjektit, M. L., trupi gjykues gjeti të drejtë

<sup>32</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR); nr. 14/2019 (JR); nr. 15/2019 (JR); nr. 20/2019 (JR) etj.

<sup>33</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 15/2019 (JR); nr.20/2019 (JR); nr. 4/2021 (JR); nr. 36/2023 (JR) etj.

qëndrimin e Komisionit, për të përfshirë në analizë vetëm likuiditetet e rezultuara në llogarinë personale të vëllait të subjektit dhe jo shumat e depozituara në llogarinë dyemërore me babanë e tij, për të cilat është provuar ligjshmëria e të ardhurave me dokumentacion justifikues ligjor, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për sa arsyetuar në vijim:

(1) Referuar dokumentacionit të të ardhurave, sipas formularëve *CUD*, sikurse trajtuar dhe më lart, rezulton se, për periudhën 2002 – 2012, Komisioni ka konstatuar se z. M. L. ka përfituar të ardhura neto, në vlerën 236.915 euro. Trupi gjykues, në analizën financiare, mban në konsideratë vlerësimin e kryer nga Komisioni, duke iu referuar shumës prej 236.915 eurosh, të përlllogaritur prej tij, pa reflektuar efektet që do të sillte në këtë shumë zbritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Shpenzimet e jetesës, ashtu si Komisioni, edhe në Kolegj janë përlllogaritur sipas Eurostat<sup>34</sup>, për 1 (një) person deri në vitin 2007 dhe për 2 (dy) persona nga viti 2008<sup>35</sup> deri në vitin 2012.<sup>36</sup>

(2) Të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, të realizuara nga bashkëshortja e vëllait në Itali, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk u provuan me dokumentacion justifikues ligjor, si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Lidhur me këto të ardhura, subjekti, në shkaqet e ankimit, por edhe në seancë dëgjimore në Kolegj, ka pranuar se ato *janë realizuar në mënyrë informale*, dhe nuk mund t'i dokumentojë dhe, si të tilla, me të drejtë nuk janë përfshirë nga Komisioni në analizë financiare.

(3) Sa i përket argumentit të subjektit në shkaqet e ankimit, se në kontratën e dhurimit është përcaktuar se apartamenti është blerë nga vëllai i tij, M. L., me kontributin sipas mundësive, edhe të dy vëllezërve të tjerë dhe motrës së tyre, trupi gjykues vëren se, edhe ky pretendim mbetet në nivel deklarativ. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e vëllezërve të tij, me qëllim justifikimin e burimit të pasurive të tjera, të krijuara po në emër të tij, të cilat ai ka pretenduar se janë financuar nga kontributi i vëllezërve me të ardhura nga bujqësia dhe blegtoaria, konkretisht pasurisë fillestare të dhuruar nga babai në vitin 2002 dhe pasurisë së blerë subjektit, nga nipi i tij në vitin 2012. Në përfundim, Komisioni, në vijim të shpjegimeve të subjektit, ka ndryshuar rezultatin lidhur me pamundësinë financiare të konstatuar për vitin 2002 dhe 2012,<sup>37</sup> për dy pasuritë e krijuara prej tij, pa kryer analizë financiare mbi mundësinë e vëllezërve për të kontribuar në këto pasuri, duke pranuar shpjegimet e subjektit, *lidhur me të ardhurat e përfituara në raport edhe me vlerësimin e situatës faktike dhe dokumenteve provuese të paraqitura prej tij*.

Subjekti në shkaqet e ankimit, sikurse dhe gjatë hetimit në Komision, ka pretenduar realizimin

---

<sup>34</sup> [Statistics | Eurostat](#)

<sup>35</sup> *Sipas regjistrimit të gjendjes civile të vitit 2008, rezulton se shtetasi M. L. është i martuar.*

<sup>36</sup> *Njësia në Kolegj ka konstatuar se, në analizën financiare fillestare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për 1 person (vetëm për vëllanë e subjektit) e, më pas, në analizën e kryer me të gjitha pasuritë e krijuara nga z. M. L., ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës për z. M. L. dhe bashkëshorten e tij.*

<sup>37</sup> *Komisionit, nga analiza paraprake e treguesve financiare, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare: (i) para fillimit të detyrës, në shumën (-) 2.074.492 lekë, për pasurinë "apartament", të blerë në vitin 2002; dhe (ii) në pamundësi financiare, në vitin 2012, në shumën (-) 2.837.633 lekë, për krijimin e pasurisë "apartament me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> dhe garazh".*

e të ardhurave nga vëllai, M. L., por edhe nga vëllezërit, si anëtarë të familjes bujqësore, duke e mbështetur këtë pretendim në “Raportin e vlerësimit për të ardhurat nga ullahtat dhe ferma blegtorale dhe bletët”, datë 16.05.2023, të ekspertes znj. L. B., në të cilin pretendohet realizimi i të ardhurave të mundshme nga ferma bujqësore, blegtorale dhe bletaria, për periudhën 2002 – 2011, në vlerën 26.969.000 lekë. Sa i përket këtij raporti, trupi gjykues vëren se ky akt nuk mund të merret në konsideratë si provë e mjaftueshme për të provuar realizimin e të ardhurave të pretenduara. Nga vetë përmbajtja e tij rezulton se vlerësimi është kryer mbi baza teorike dhe supozime, pasi ekspertët deklarojnë shprehimisht se nuk janë në gjendje të raportojnë nëse numri i bagëtimeve, i bletëve apo i rrënjëve të ullinjve kanë dhënë prodhimin e përlllogarit, ndërsa përlllogaritjet janë mbështetur në analiza dhe studime të përgjithshme, si dhe në numrin e mundshëm të krerëve të shitur, të deklaruar nga kërkuesit. Po kështu, raporti supozon se produktet e prodhuara mund të jenë shitur në treg të hapur, pa identifikuar blerës konkretë apo transaksione të verifikueshme.

Në këto kushte, të dhënat e pasqyruara në këtë raport përfaqësojnë vlerësime hipotetike mbi të ardhura të mundshme dhe jo të ardhura të provuara e të realizuara faktikisht. Për më tepër, ato nuk u provuan me dokumentacion justifikues ligjor, si dokumente tatimore, regjistra shitjesh, kontrata, fatura, mandate apo prova të tjera që të mundësojnë verifikimin e prodhimit, shitjes dhe përfitimit efektiv të të ardhurave të pretenduara. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se raporti nuk përbën provë të mjaftueshme për të provuar ekzistencën e të ardhurave, si në drejtim të realizimit të vlerës së pretenduar në shkaqet e ankimit, ashtu dhe në funksion të ligjshmërisë së tyre, për sa kohë nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor realizimi i tyre, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, në ndryshim dhe nga rasti i sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, i trajtuar në jurisprudencën e Kolegjit.

Ndonëse nga vendimi i Komisionit, duket se ky i fundit nuk ka konkluduar për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, pasi ka konsideruar të ardhurat e familjes bujqësore nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale, duke përmbysur balancat negative të konstatuara për këto dy pasuri, të krijuara përkatësisht në vitet 2002 dhe 2012, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, bazuar në sa arsyetuar më sipër, vlerëson se këto të ardhura nuk kalojnë testin e ligjshmërisë sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, por në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, nuk analizoi efektin financiar që ky vlerësim sjell për këto dy pasuri, si dhe në kontributin që vëllezërit kanë dhënë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, por e mbajti atë në konsideratë në drejtim të besueshmërisë së deklaratimit të subjektit për kontributin e tyre, si dhe për krijimin e bindjes lidhur me burimin real të krijimit të kësaj pasurie objekt kontrolli.

Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi si jashtë logjikës ekonomike dhe jobindës, pretendimin e subjektit se vëllezërit dhe motra e tij, të cilët jetonin dhe ushtronin aktivitet kryesisht në zonë rurale, kanë financuar blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, për prindërit e tyre, madje më të madh se apartamenti prej 74 m<sup>2</sup>, i vetë subjektit të rivlerësimit, e më pas ia kanë dhuruar këtë pasuri atij, ndonëse ai ushtronte funksionin e prokurorit dhe dispononte të ardhura dukshëm më të larta se familjarët e tij.

(4) Në vijim të analizimit të vlerës provuese të aktit *Deklaratë zëvendësuese, akt noterial, datë 08.06.2023, e z. S. G., ish-administrator i “{\*\*\*} {\*\*\*}”, i paraqitur nga subjekti së bashku me*

ankimin, trupi gjykues konstaton se me këtë deklaratë synohet të vërtetohet se vëllai i subjektit, M. L., ka qenë punonjës social pranë kësaj shoqërie për një periudhë 4-vjeçare, 2005 – 2009, gjatë kohës që ai ka qenë administrator, si dhe ka kryer detyrat e infermierit, për të cilën ka përfituar pagesën fikse neto mujore 1.800 euro, në total, në vlerën 86.400 euro. Trupi gjykues, referuar ekstraktit historik të përcjellë me deklaratën, vëren se shoqëria “{\*\*\*}” {\*\*\*} është themeluar më datë 07.02.2005, por aktiviteti i shoqërisë ka filluar më datë 31.05.2005, ndërkohë që administratori rezulton të jetë larguar nga kjo detyrë më datë 13.06.2009. Trupi gjykues vlerëson se kjo deklaratë noteriale përbën një deklaram të njëanshëm të ish-administratorit të shoqërisë dhe, si e tillë, mbetet në nivel deklarativ. Në kushtet kur përmbajtja e saj nuk mbështetet në dokumentacion shoqëruës, që të provojë marrëdhënien e punës së pretenduar, pagesat e kryera, deklarin e të ardhurave pranë organeve kompetente apo përmbushjen e detyrimeve tatimore e shoqërore përkatëse, nuk provon as ekzistencën dhe masën e të ardhurave të pretenduara të përfituara nga M. L. pranë kësaj shoqërie. Trupi gjykues vlerëson se marrja e këtij akti si provë është e panevojshme dhe nuk ndikon në marrjen e vendimit, duke mos plotësuar kriteret e pranueshmërisë së provës, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, geramat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër arsyetuar, edhe nga kontrolli i treguesve të analizës financiare në Kolegj, trupit gjykues i rezultoi e provuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e dy apartamenteve dhe garazhit më datë 11.06.2012, në vlerën totale 9.812.950 lekë, si dhe blerjen e apartamentit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, dhuruar subjektit më datë 19.06.2012, në vlerën 4.982.000 lekë, pasi rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në shumën (-) 80.179 euro.

Sa i përket pretendimeve të përsëritura të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si në Komision, ashtu dhe në Kolegj, se ai ka pasur vetë mundësi financiare për të blerë apartamentin me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të pranohej se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se kjo rrethanë e vetme, e paharmonizuar me rrethanat, faktet dhe provat si më sipër referuar në vendim, nuk krijon bindjen për sa pretendon subjekti, pra që pasuria apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup> ka pasur si burim të krijimit të saj, dhurimin e bërë nga vëllai, z. M. L.. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se pasja e mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie nuk e zhvesh subjektin nga detyrimi për të provuar saktësinë e deklarimeve dhe ligjshmërinë e burimeve për pasuritë e krijuara dhe të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në përfundim, bazuar në sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues, krijimin e bindjes për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}” në Vlorë, për rrjedhojë, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, e mbështeti në një vlerësim harmonik të disa rrethanave, fakteve dhe provave si: (i) kronologjia e kryerjes së transaksioneve për blerjen e pasurive në vitin 2012; (ii) fakti që vëllai i subjektit nuk ka qenë në Shqipëri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes; (iii) mungesa e rrethanave të besueshme mbi nevojat e blerjes së kësaj pasurie nga vëllai, z. M. L.; (iv) qëllimi i krijimit të marrëdhënies së dhurimit; (v) posedimi dhe përdorimi vetëm nga subjekti i rivlerësimit i kësaj pasurie; si dhe, (vi) mungesa e burimeve financiare të ligjshme, e rezultuar për kryerjen e këtyre investimeve nga vëllai, në shumën (-) 80.179 euro.

***Për pasuritë: (1) “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, dhe (2) “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}***

19. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, parashtron të njëjtat pretendime në lidhje me këto dy pasuri, duke vënë në diskutim përfundimin e Komisionit për mungesë burimesh financiare. Sipas tij, barra e provës nuk i ka kaluar për këtë rrethanë, ndërkohë që vetë Komisioni ka vlerësuar se ai kishte mundësi financiare për krijimin e këtyre pasurive.
20. Trupi gjykues, nga analiza e vendimit të Komisionit, akteve të administruara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ, si dhe shkaqeve të ankimit të subjektit, konstaton dhe vlerëson se:
21. ***(1) Lidhur me pasurinë “automjeti”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, shitur në vlerën 500.000 lekë***

21.1. Komisioni, në përfundim, lidhur me këtë pasuri ka çmuar se: [...] *deklarimet e subjektit në deklarata periodike dhe atë vetting për çmimin e blerjes dhe shitjes së këtij automjeti, blerë më lirë e shitur më shtrenjtë, pa deklaruar shpenzime, por deklaruar ato vetëm përgjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, i bëjnë të pabesueshme deklarimet e tij. Në këtë këndvështrim, Komisioni ka vlerësuar se, lidhur me këtë pasuri, subjekti rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë, duke deklaruar çmim joreal për blerjen dhe shitjen, më pas, të kësaj pasurie. [...]*

21.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se më datë 16.02.2012 ka blerë automjetin e targuar {\*\*\*}, me kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., në vlerën 400.000 lekë, me burim *kursime nga paga dhe vitet e mëparshme*. Më datë 10.04.2013, ka shitur automjetin me targa {\*\*\*}, me kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 10.04.2013, në vlerën 500.000 lekë.<sup>38</sup>

21.3. Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit me targa {\*\*\*}, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 16.02.2012, në vlerën 400.000 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit, si dhe ka deklaruar në vitin 2013 shitjen e tij përmes kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 10.04.2013, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

21.4. Komisioni ka përgatitur analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për blerjen e këtij automjeti në vitin 2012, duke marrë në konsideratë kursimet *cash*, me burim të ardhura nga paga, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit është me mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në shkurt të vitit 2012 dhe, me rezultatet e hetimit, i ka kërkuar subjektit shpjegime dhe dokumentacion provues, pasi ka konstatuar se çmimi i shitjes së automjetit pas një viti, në vlerën 500.000 lekë, është më i lartë se çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit.

21.5. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, lidhur me diferencën ndërmjet çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së automjetit, subjekti ka shpjeguar, se automjeti është blerë me targa të huaja dhe se vlera e tij është rritur si pasojë e pagesës së taksave dhe tarifave të regjistrimit në DRShTRr, riparimit të një defekti në motor, si dhe shpenzimeve të kryera për siguracionin dhe taksat

---

<sup>38</sup> *Konfirmuar edhe nga aktet në fashikullin e DPShTRr-së.*

vjetore. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.05.2023, të shtetasit E. Ç., i cili deklaron se i ka kryer shërbime automjetit në servisën e tij dhe se këto ndërhyrje kanë ndikuar në rritjen e vlerës së mjetit.

21.6. Në përfundim, Komisioni ka çmuar se deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike dhe atë *vetting* për çmimin e blerjes dhe shitjes së këtij automjeti, për diferencën në çmim 100.000 lekë, *pa deklaruar shpenzime*, por deklaruar ato vetëm përgjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, i bëjnë jo të besueshme deklaratimet e tij. Në këtë këndvështrim, Komisioni ka vlerësuar se, lidhur me këtë pasuri, subjekti rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë, duke deklaruar çmim joreal për blerjen dhe shitjen, më pas, të kësaj pasurie.

21.7. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri financiare nuk gjendet i reflektuar në rezultatet e hetimit administrativ, si dhe nuk gjen mbështetje në rrethanat konkrete të çështjes. Nga analiza financiare e kryer në Komision, por dhe në Kolegj, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit. Nga aktet e administruara, nuk rezulton që Komisioni të ketë identifikuar rrethana të tjera me relevancë për procesin e rivlerësimit, ndërsa diferenca e konstatuar, për shkak të vlerës së saj jodomethënëse dhe faktit se nuk tejkalonte pragun e deklarimit të përcaktuar në formularët e deklarimit periodik vjetor të viteve përkatëse, nuk është e mjaftueshme për të mbështetur konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri.

22. **(2) Lidhur me pasurinë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, blerë në vlerën 600.000 lekë**

23. Komisioni, në përfundim, lidhur me këtë pasuri ka çmuar se: [...] *çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit është dukshëm më i ulët se vlera reale e tij e se deklaratimet e subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit kalimtar janë të pabesueshme. Në këtë këndvështrim, Komisioni ka vlerësuar se, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë, duke deklaruar çmim joreal për blerjen e kësaj pasurie...[...]*

23.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se më datë 27.05.2013 ka blerë automjetin e targuar {\*\*\*}, me kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., në vlerën 600.000 lekë, me burim të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*} dhe kursime nga vitet e mëparshme. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në deklaratën periodike të vitit 2013, pa deklaruar burimin e krijimit.

23.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRr-së, rezulton se automjetin, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, vit prodhimi 2003, referuar kontratës datë 13.03.2013, shtetasja E. P. e ka blerë nga shtetasi N. S., në shumën 5.100 euro. Ky automjet ka hyrë në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet pikës doganore Vlorë, si dhe është paguar tarifa e zhdoganimit, prej 144.547 lekësh, nga shtetasja E. P., në total me një kosto prej 859.618 lekë<sup>39</sup>.

---

<sup>39</sup> Në bazë të kursit të këmbimit të monedhës euro, në lekë, të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2013, vlera e blerjes së automjetit nga shtetasja E. P. ishte 715.071 (shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e një) lekë, llogaritur së bashku me vlerën e zhdoganimit prej 144.547 (njëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekësh.

Nga aktet rezulton se, rreth dy muaj më pas, me kontratën e datës 27.05.2013, subjekti e ka blerë këtë automjet në vlerën 600.000 lekë, çmimi ky më i ulët se çmimi fillestar i blerjes prej 859.618 lekësh.

23.3. Komisioni ka përgatitur analizën financiare të subjektit për blerjen e këtij automjeti në maj të vitit 2013 në të dy variantet dhe, sipas vlerës së kontratës, ashtu edhe sipas vlerës së rezultuar nga aktet, nga e cila ka rezultuar se ai ka mundësi financiare të krijojë pasurinë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, si dhe të krijojë dhe të shtojë gjendjen *cash* në fund të vitit 2013 dhe, me rezultatet e hetimit paraprak, i ka kërkuar subjektit shpjegime, si dhe të paraqesë dokumentacion provues mbi çmimin e blerjes së këtij automjeti, i cili ka rezultuar më i ulët se çmimi fillestar i blerjes së kësaj pasurie.

23.4. Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka pretenduar se ky automjet ka shfaqur probleme mekanike në sistemin e frenimit *SBC* dhe, për këtë arsye, vlera e shitjes së tij nga shitësja E. P. është më e ulët se vlera e blerjes, duke iu referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.05.2023, të shitëses, dhe deklaratës noteriale të shtetasit E. Ç..

23.5. Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit është dukshëm më i ulët se vlera reale e tij e se deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ janë të pabesueshme. Në këtë këndvështrim, Komisioni ka vlerësuar se, lidhur me këtë pasuri, subjekti rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë, duke deklaruar çmim joreal për blerjen e kësaj pasurie.

23.6. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, ndonëse kontrata noteriale e shitblerjes, nr. {\*\*\*} rep. / {\*\*\*} kol., datë 27.05.2013, parashikon se automjeti me targa {\*\*\*} është blerë në vlerën 600.000 lekë dhe përbën referencën ligjore të transaksionit, aktet e administruara sugjerojnë një vlerë fillestare më të lartë të kësaj pasurie, në shumën 859.618. Për këtë arsye, ashtu si edhe Komisioni, trupi gjykues e gjeti të drejtë kryerjen e analizës financiare në të dyja versionet e mundshme të vlerës së automjetit, nga e cila ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. Gjithashtu, nga aktet në dosje dhe vendimi i Komisionit, nuk rezulton të jenë evidentuar rrethana të tjera me relevancë për procesin e rivlerësimit, që të mbështesnin konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri.

23.7. Sa trajtuar më sipër, shkaqet e ankimit të subjektit lidhur me pasuritë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*} dhe me targa {\*\*\*}, edhe pse u gjendën të drejta nga trupi gjykues, u konsideruan të pamjaftueshme për ndryshimin e vendimit të Komisionit.

24. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Hyrjet Lamaj nuk ka arritur nivelin e besueshmërisë, të parashikuar nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për konfirmimin e tij në detyrë.

25. Në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues, për gjithë sa ka rezultuar e provuar gjatë hetimit administrativ, si dhe bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, çmon se vendimi i Komisionit është i mbështetur në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.06.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi – kundër*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes (JR) nr. 36/2023, kam mbajtur qëndrim kundër shumicës së trupit gjykues, lidhur me vendimin nr. 47, datë 16.06.2025, që i përket subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj, çështje e cila u gjykua në Kolegj, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit, kundër vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është vendosur: *Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, z. Hyrjet Lamaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Në cilësinë e gjyqtares në pakicë, kundërshtoj vendimin e marrë nga shumica e trupit gjykues, pasi konstatoj se, nuk janë vlerësuar drejt rrethanat e fakteve në përputhje me ligjin, me provat e administruara në dosje, rrjedhojë e konstatimit të gjendjes faktike në mënyrë jo të plotë dhe të pasaktë, me pasojë zgjidhjen jo të drejtë të çështjes, për sa do të arsyetoj në vijim.

### A. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

A/1 Lidhur me pasurinë “Apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>”, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë

2. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, konkluzioni i Komisionit dhe i shumicës së trupit gjykues nuk mbështetet në një analizë objektive, të plotë dhe të balancuar të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje, por në një interpretim të zgjeruar të disa rrethanave, të cilat, për mua, nuk qëndrojnë në raport me standardin ligjor të vlerësimit të pasurive, të parashikuar sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, aq më pak nuk mund të bëjnë të zbatueshëm nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

2.1. *Së pari*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin e tij kushtetues dhe ligjor për të deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë e tij, në përputhje të plotë me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për sa në vijim.

2.1.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Me kontratën e dhurimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2015, unë dhe bashkëshortja kemi përfituar pronësinë mbi sipërfaqen e banimit prej 94 m<sup>2</sup>, e cila ka qenë banesa e prindërve, por e regjistruar në emër të vëllait, M. L., blerë nga motra dhe vëllezërit. (Kjo banesë ndodhet ngjitur me banesën e përshkruar në pikën “5” dhe aktualisht i kam bashkuar në një të vetme, dhe ndodhen në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, ku banoj aktualisht.) Vlerësuar sipas çmimit të tregut në kohën e lidhjes së kontratës, në shumën prej 5.795.570 lekë”.

2.1.2. Deklarimet e subjektit gjejnë mbështetje dhe në aktin noterial të kohës, kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2015, me objekt: *Dhurimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, lagjia {\*\*\*}, Vlorë*, e cila, referuar nenit 690 të Kodit Civil, ka forcën e ligjit për palët. Po ashtu, neni 253 i Kodit të Procedurës Civile, përcakton se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”. Për rrjedhojë, kontrata noteriale e dhurimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2015, për pasurinë apartament banimi, përbën provë të plotë dhe kundrejt të tretëve, në lidhje me rrethanat e deklaruara mbi përfitimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit.

2.1.3. Në kontratën e dhurimit citohet se: [...] *Pasuria objekt dhurimi, edhe pse është në pronësi të M. L. dhe E. L., është financim i vëllezërve dhe motrës së Hyrjet Lamaj. Kjo dhuratë i bëhet vëllait të tyre, Hyrjet Lamaj e bashkëshortes së tij, E. L., për kontributin që ata kanë dhënë dhe japin për kujdesin ndaj prindërve të tyre, pasi sipas një marrëveshjeje të përbashkët, prindërit do të jenë nën kujdesin e djalit të tyre, Hyrjet Lamaj, të cilët janë kujdesur e kujdesen duke iu krijuar kushte shumë të mira jetese, kurim e gjithçka tjetër që atyre u duhet [...].*

2.1.4. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, ka deklaruar përfitimin e kësaj pasurie përmes kontratës së dhurimit, *të ndodhur në kufi të banesës që ka në pronësi dhe banon.* Subjekti ka deklaruar që kjo banesë është kontribut i vëllezërve dhe motrës, dhe se në këtë banesë kanë banuar dhe banojnë prindërit e tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, iu ka njohur deklaratave periodike të pasurisë, *vlerën e provës*, qëndrim ky i mbajtur dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

2.1.5. Sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në përputhje me ligjin e zbatueshëm, kontratën e dhurimit, kontributin e financimit të familjarëve, si dhe qëllimin për të cilin kjo pasuri i është dhuruar, duke vënë në dispozicion të organeve të rivlerësimit të gjitha elementet e nevojshme për kryerjen e një kontrolli të plotë administrativ dhe financiar mbi këtë pasuri duke mos qenë asnjëherë kontradiktor në deklaratimet e tij, në përputhje me nenin 33 pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

2.2. *Së dyti*, fakti që vëllai i subjektit të rivlerësimit ka blerë apartamentin objekt dhurimi në të njëjtin kat, në të njëjtën periudhë kohore dhe ngjitur me apartamentin e subjektit, nuk mund të shërbejë si indicie e mjaftueshme për të arritur në konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, mbi ekzistencën e një deklarimi të rremë. Përkundrazi, në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, kjo rrethanë rezulton në përputhje të plotë me deklaratimet periodike të subjektit, si dhe qëllimin e deklaruar në mënyrë konstante, për kujdesjen ndaj prindërve në një ambient banimi pranë banesës së tij.

2.3. *Së treti*, në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, konkluzioni i shumicës lidhur me mungesën e burimeve financiare të vëllait të subjektit, për blerjen e këtij apartamenti, rezulton i pambështetur. Aktet në dosje dëshmojnë për kontribut të përbashkët familjar të vëllezërve dhe motrës, për blerjen e kësaj pasurie, dhe jo vetëm kontributin e vëllait të tij, M. L.. Analiza e të gjitha shpenzimeve dhe investimeve vetëm të M. tejkalon objektin e kontrollit në procesin e rivlerësimit, tejkalon rregullin e përcaktuar në ligj dhe konkretisht nenin 32, pika 4 e ligjit 84/2016. Për më tepër, në analizën e shumicës nuk është vlerësuar dhe as nuk është përmendur që subjekti kishte mundësi financiare të ligjshme për ta blerë vetë apartamentin objekt shqyrtimi. Në këto rrethana, në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti nuk kishte asnjë arsye të ndërtonte artificialisht një marrëdhënie dhurimi për një apartament, për blerjen e të cilit kishte mundësi ta blinte vetë atë me të ardhura të ligjshme, fakt i cili nuk shkon në drejtim të konkluzionit të shumicës për deklaratim të rremë. Shumica e trupit gjykues, në vendimmarrjet e saj të mëparshme, ka qenë më e balancuar, në analizë të nenit 32/4, për personat dhurues, dhe analizimin e mundësive të tyre për të dhuruar, në këtë rast, jo

vetëm që nuk u morën parasysh pretendimet e subjektit të rivlerësimit, por shkuan edhe më tej nga sa parashikon ligji.

2.4. *Së katërti*, argumenti i përdorur nga shumica e trupit gjykues, se prindërit rezultojnë të regjistruar në gjendjen civile të fshatit Novoselë dhe se në banesën e tyre ka pasur konsum energjie elektrike, nuk mund të dëshmojë se ata nuk kanë jetuar apo qëndruar edhe në apartamentin e tyre në Vlorë. Regjistrimi formal i adresës nuk përjashton përdorimin paralel të një banese tjetër. Po kështu, ekzistenca e konsumit të energjisë në banesën në fshat nuk është element përjashtues për përdorimin e apartamentit në qytet, sidomos për persona të moshuar, të cilët mund të kenë lëvizur periodikisht ndërmjet dy banesave. Në këtë kuptim, shumica e trupit gjykues i ka atribuar kësaj rrethane një vlerë provuese më të gjerë nga sa ajo objektivist mbart, duke arritur në një konkluzion përjashtues mbi bazën e indicieve dhe jo mbi prova të drejtpërdrejta, që të provojnë mungesën faktike të qëndrimit të prindërve në apartamentin objekt shqyrtimi.

Në përfundim, konkluzioni i shumicës së trupit gjykues mbështetet vetëm mbi dyshime dhe jo mbi prova bindëse, për sa argumentuar më sipër, të gjitha rrethanat e analizuara më krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit është i vërtetë në ato që ka deklaruar, pasi:

(i) Ka kryer deklarime të sakta në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore, kohë e cila përputhet me veprimin juridik të dhurimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Këto deklarime mbështeten dhe në dokumentacionin e administruar në funksion të zgjidhjes së çështjes, si në kontratën e dhurimit etj., duke i bërë kështu të besueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

(ii) Vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e dhuruesit, provoi mundësinë financiare për krijimin e pasurisë së dhuruar. Nga hetimi rezultoi se ai dispononte në llogari bankare likuiditete të mjaftueshme, edhe më shumë sesa vlera e apartamentit objekt shqyrtimi, pikërisht në momentin e kryerjes së veprimit juridik të blerjes së këtij apartamenti.

(iii) Po ashtu, vetë subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, për ta blerë vetë pasurinë objekt shqyrtimi dhe nuk kishte asnjë arsye që ta adresojë atë si të blerë nga vëllai i tij, për ta trajtuar më pas në formë dhurimi. Për mua që nga ky moment do t'i vlerësoja deklaratimet e subjektit të rivlerësimit bindëse dhe të mbështetura në prova dhe në fakte të provuara ligjërisht, dhe nuk do të shkoja më tej në analizë të personave të tjerë të lidhur sipas ligjit.

(iv) Rrethanat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbështesin logjikën e një marrëdhënieje familjare, ku prindërit duhet të kenë një vendqëndrim afër fëmijëve, për më tepër në kushtet kur vetëm subjekti i rivlerësimit banonte në qytetin e Vlorës.

3. Në mungesë të provave që të provojnë të kundërtën e konstatimeve të mësipërme, në vlerësimin tim, vendimi i shumicës së trupit gjykues, për zbatimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “ç” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezulton i gabuar, joproporcional dhe në tejkalim të standardit kushtetues të kontrollit të vlerësimit të pasurisë.

4. Në konkluzion të sa më sipër, vlerësoj se provat e administruara, në harmoni me faktet e provuara prej tyre, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit Hyrjet Lamaj ka qenë i vërtetë në deklaratimet e tij, ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, shumica e trupit gjykues duhet të vendoste ndryshimin e vendimit nr. 668, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e tij në detyrë.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*